



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 07.02.2022

PËRGJIGJE

MBI PYETJET E NGRITURA NË SEANCËN GJYQËSORE TË DATËS 3.02.2022

Drejtuar: GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Të nderuar,

Në seancën gjyqësore të datës 3 shkurt 2022, Gjykata Kushtetuese i adresoi Presidentit të Republikës disa pyetje, lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, duke caktuar vijimin e seancës në datën 7 shkurt 2022, ora 10:00.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së të gjithë pyetjeve, rezultoi se disa prej tyre në dukje përmbajnë elementë të paragjyqimit të çështjes dhe mund të jenë të ndikuara nga perceptimi propagandistik.

Gjithashtu, për shumë prej pyetjeve që Gjykata ngriti në seancën publike në datën 3 shkurt 2022, Presidenti i Republikës ka dhënë qëndrimin dhe ka parashtruar kërkimet e tij në mënyrë shteruese, dhe shumë të qartë, që prej korrikut 2021, përmes Aktit nr. 2143 prot., datë 1.7.2021, duke kërkuar njëkohësisht shqyrtimin e çështjes brenda një kohe sa më të shpejtë, që do të duhej të përkonte edhe me përfundimin e mandatit të Legjislaturës së IX-të, të Kuvendit të Shqipërisë.

Nëse Gjykata do të kishte shqyrtuar me vëmendje të thelluar këto qëndrime të Presidentit të Republikës, apo dhe provat që e shoqërojnë atë, shumë prej pyetjeve sot nuk do të ekzistonin.

Megjithatë, në respekt të transparencës së plotë, si dhe në përgjigje të kërkesës së trupës gjyqësore, ju parashtrojmë përgjigjet si më poshtë vijon, duke mbajtur në konsideratë faktin se shumë prej pyetjeve janë përsëritje e njëra-tjetrës, si dhe faktin se Gjykata nuk mundi të na i përcillte pyetjet e zbardhura (*përveç pyetjeve të relatorit*), ndërkohë që përmbajtja e tyre, është zbardhur nga përfaqësuesit e Presidentit të Republikës me shkrim dore në seancën e datës 3.02.2022.

MBI PYETJET E GJYQTARIT-RELATOR, Z. PËRPARIM KALO

1. Gjykata ju ka përcjellë, krahas vendimit të Kuvendit edhe provat përkatëse: deklarata e qëndrime tuajat në kanale televizive, në konferenca shtypi, takime, postime në *Facebook*, faqen zyrtare në website, etj. A keni paraprakisht ndonjë rezervë për vërtetësinë e tyre?

Përgjigje: Provat e marra, përmes një procesi të parregullt ligjor, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe rregullat e përcaktuara për këtë qëllim, ashtu siç dhe kemi parashtruar, janë të papërdorshme dhe të pavlefshme.

Të gjitha provat që Kuvendi pretendon se ia ka depozituar Gjykatës Kushtetuese, janë marrë përmes një procesi antikushtetues, në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e ligjit nr. 8891/2002, dhe Rregullores së Kuvendit. Rrjedhimisht, dhe produkti i prodhuar duke u bazuar mbi to, është i pavlefshëm dhe i papërdorshëm.

Siç është kërkuar në parashtrimet tona, Gjykata kushtetuese ka për detyrë të shfuqizojë të gjitha vendimet e Kuvendit të Shqipërisë.

2. Pretendoni se mandati i legjislaturës së mëparshme ka përfunduar dhe qëndrimet vijuese të paraqitura nga Kryetarja e legjislaturës aktuale nuk janë konfirmuar formalisht nga Kuvendi (shumica parlamentare). **Jepni shpjegime më të qarta për këtë argument, në kuadër të parimit të vazhdimësisë institucionale?**

Përgjigje: Legjislatura e X-të aktuale e Kuvendit, nuk mund të përfaqësojë vullnetin për kërkimin që i ka bërë Gjykatës Kushtetuese Legjislatura e kaluar (IX-të), të cilës i ka përfunduar mandati në 9 shtator 2021.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka thjesht dhe vetëm funksione të administrimit të veprimtarisë administrative të Kuvendit të Shqipërisë, e që përfaqëson Legjislaturën e X-të në marrëdhënie me të tretë, nuk ka asnjë tagër që të zëvendësojë, të përfaqësojë, apo të konfirmojë vullnetin e trupës së deputetëve që mori vendimin nr. 55/2021, në Legjislaturën IX-të.

Kjo trupë është tërësisht e ndryshme nga përbërja aktuale e Legjislaturës së X-të, kur vetëm 40 deputetë aktualë kanë qenë deputetë në legjislaturën e kaluar kur u votua për shkarkimin e Presidentit.

Kryetarja e Kuvendit nuk ka asnjë tagër të zëvendësojë apo të marrë vendimet që Kuvendi i Shqipërisë i merr vetëm në seancë plenare me votimin e drejtpërdrejtë të deputetëve të saj!

Referuar parimit të vazhdimësisë midis dy legjislatrave, vetë Kuvendi i Shqipërisë, sipas nenit 87/1, të Rregullores së Kuvendit, me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve të Kuvendit, projekt aktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të Kuvendit, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare, ia kthen

nismëtarit. Edhe kur nismëtari është sërish deputet, duhet ta ri paraqesë nismën, dhe Seanca Plenare duhet të votojë për përfshirjen e saj në programin e punimeve të Kuvendit.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një vendim që nuk ka natyrë rregullatore/normuese, që të pretendohet se duhet të respektohet parimi i vazhdimësisë, por vendimi nr. 55/2021, i Kuvendit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, është kërkesa që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e cila duhet ta kishte shqyrtuar tërësisht këtë çështje brenda 3 muajve dhe maksimalisht deri në datën 9 shtator 2021.

Vetëm në këtë mënyrë, Gjykata do të mund të merrte vullnetin e Legjislaturës së IX-të, nëse i qëndronte ose jo kërtimeve të paraqitura, pavarësisht se këtë kërkim e ka formalizuar përmes një akti të quajtur vendim.

Arsyet e tjera janë të parashtruara në qëndrimin depozituar Gjykatës Kushtetuese që prej datës 1 korrik 2021, në kërkesat e Presidentit të Republikës të depozituara në muajin tetor-nëntor 2021, si dhe në kërkesën paraprake të depozituar në seancën e datës 1 shkurt 2022.

3. Një pretendim tjetër është se sipas nenit 27, pika 5, të Rregullores së Kuvendit, përcaktimi i rendit të ditës nuk mund të bëhet më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të seancës së planifikuar. Po ashtu, ngritja e Komisionit Hetimor nuk ka qenë e përfshirë në rendin e ditës të caktuar nga Kryetari i Kuvendit, që do të thotë se është shkelur neni 31 i Rregullores, që përcakton procedurën që ndiqet për ndryshimin e rendit të ditës të seancës plenare. **Këtë pretendim e mbështesni në faktin se në dosjen përkatëse që përfshin diskutimet dhe vendimmarrjen e Kuvendit të seancës së datës 7 maj nuk është shqyrtuar një kërkesë e tillë? Jepni shpjegime më të qarta për këtë pretendim.**

Përgjigje: Kuvendi mbart detyrimin që të informojë publikun e gjerë. Për këtë arsye, gjithë aktet mbi veprimtarinë e tij parlamentare duhet t'i publikojë në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni.

Në këtë faqe, për çdo seancë plenare, publikohet jo vetëm çdo akt i depozituar, por deri në aktet e brendshme, duke filluar që nga urdhri i Kryetarit të Kuvendit për përcaktimin e rendit të ditës së seancave plenare, vetë rendi i ditës, përmbajtja e projekt akteve dhe veprimtaria e komisioneve respektive.

Siç dhe kemi parashtruar në qëndrimet dhe pretendimet e Presidentit të Republikës, depozituar përmes shkresës nr. 2143 prot., datë 1 korrik 2021, (faqe 106 – 111)¹, nga praktika parlamentare e publikuar *online*, rezulton i botuar dhe Urdhri nr. 19, datë 6.5.2021, i Kryetarit të Kuvendit, lidhur me seancën plenare të datës 7 maj 2021.

Lidhur me këtë proces konstatohen dhe dy shkelje të tjera, pasi në rendin e ditës nuk ishin përfshirë projektvendimi për ngritjen e Komisionit Hetimor, dhe nga ana tjetër rendi i ditës për

¹ Konsultohuni me procesverbalet parlamentare të përmbledhura të publikuara për seancën e datës 7 maj 2021 <https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>

thirrjen e Seancës Plenare nuk është publikuar 2-ditë përpara datës së caktuar për seancë, siç kërkon Rregullorja e Kuvendit. Në shtojcën 1, (pika 10), dhe në dokumentacionin që i kemi depozituar Gjykatës Kushtetuese që në datën 1 korrik 2021, evidentohet **Urdhri nr. 19, datë 6.5.2021 i Kryetarit të Kuvendit, me nr. 1110 prot., datë 6.5.2021** “Për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 07.05.2021, ora 10.00”, si dhe bashkëlidhur rendi i Ditës i Seancës Plenare Publike për aktet që shqyrtohen nga Kuvendi në këtë seancë, nxjerrë nga faqja e Kuvendit, në *link*-un: <https://www.parlament.al/Document?tipId=1&dokumentId=6034>.

Kuvendi i Shqipërisë, deri më sot nuk e ka kundërshtuar këtë pretendim të Presidentit të Republikës, lidhur me këtë shkelje. Gjithashtu, provat tepër të qarta për këtë shkelje, janë depozituar që prej datës 1 korrik 2021.

Megjithatë, pasi Kuvendi u njoh në datën 3.02.2022 me pyetjet që Gjykata Kushtetuese i drejtoi Presidentit, menjëherë në mënyrë të habitshme, të pakërkuar nga asnjë prej palëve dhe as nga vetë Gjykata në seancë, u vetë aktivizua dhe me shkresën nr. 1368/15 prot., datë 4.2.2022 (një ditë pas seancës gjyqësore publike) depozitoi në Gjykatën Kushtetuese, prova shtesë ku përfshihet kopje e njehsuar e:

- Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit nr.19, datë 05.05.2021, me Nr. 1110 prot., datë 06.5.2021, si dhe bashkëlidhur tij Rendi i Ditës së Seancës Plenare të datës 7 maj 2021.

Gjykata Kushtetuese, duhet të marrë seriozisht vërtetësinë e kësaj prove, pasi në krahasim nga dy dokumentet, pra atë që është publikuar në faqen zyrtare të internetit në maj 2021, jo thjesht në format *PDF* elektronik, por i skanuar në formën e tij të nënshkruar dhe vulosur rregullisht nga Kryetari i Kuvendit, me atë që depozitohet sot si provë shkresore. Mes këtyre dy versioneve rezultojnë qartë disa ndërhyrje që ngrenë **dyshime të forta për manipulim të këtij dokumenti**, me qëllim rrëzimin e pretendimeve të faktuara të Presidentit të Republikës për shkeljet procedurale që ka kryer Kuvendi i Shqipërisë gjatë gjithë procesit të ndërmarrë për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Jemi thellësisht të tronditur se si mundet organi i Kuvendit të Shqipërisë, apo administrata e tij, që në përmbushje të një qëllimi të pastër politik, për të mbrojtur para Gjykatës shkeljet që ka kryer në mënyrë flagrante, arrin të manipulojë dhe përmbajtjen e akteve të veta.

Konkretisht, dallimet që janë tepër të qarta e të dukshme, po i citojmë:

1) Ka ndryshime të dukshme në datën e urdhrit nr. 19, të Kryetarit të Kuvendit. Në praktikën e publikuar *online* në maj 2021, urdhri nr. 19 i Kryetarit të Kuvendit, mban datën **06.05.2021**, ndërkohë që në praktikën që në mënyrë të pa kërkuar është depozituar nga Kuvendi në datën 4.2.2022, Urdhri nr. 19, i Kryetarit mban datën dy data: mban datën 05.05.2021, në krah të numërtimit të Urdhrit, dhe mban datën 6.05.2021, në krye të tij. Pra, lehtësisht konstatohet:
-një ndërhyrje tek data e urdhrit, në raport me aktin e publikuar *online*;
-një datë e ndryshme brenda të njëjtit akt, në versionin e përcjellë si kopje e njehsuar pranë Gjykatës Kushtetuese.

2) Ka ndryshime të dukshme sa i takon pikës 20, të Urdhrit nr. 19, të Kryetarit të Kuvendit ku përcaktohet se çfarë do të shqyrtohesh në datën 7 maj 2021, lidhur me çështjen e shkarkimit të Presidentit, duke ndryshuar përmbajtja e rendit të ditës.

Konkretisht, në Urdhrit nr. 19, datë 06.05.2021, publikuar në faqen e Kuvendit të Shqipërisë pika 20 ka këtë përmbajtje:

- *“Projektvendim “Për miratimin e raportit dhe propozimit të komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.*

Ndërkohë që, në Urdhrit nr. 19, datë **05.05.2021** (?!), të paraqitur si provë shtesë nga Kuvendi me shkresën nr. 1368/15 prot., datë 04.02.2022, përcjellë pranë Presidentit nga Gjykata Kushtetuese, pika 20 e këtij urdhri ka këtë përmbajtje:

- *“Projektvendim “Për raportin dhe propozimin e komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen **ose mos ngritjen** e një komisioni hetimor, për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.*

Pra siç qartësisht është e dallueshme, në këtë urdhër që Kuvendi u kujtua t`ia dërgojë Gjykatës Kushtetuese në formë shkresore në datën 4.2.2022, pa iu kërkuar, është hequr fjala “miratim”, fjala “raportit” është zëvendësuar me fjalën “raportin”, fjala “propozimit” është ndryshuar me fjalën “propozimin”, lidhëza “të”, është zëvendësuar me lidhëzën “e”, pas fjalës “ngritjen”, është shtuar fjala “ose mos ngritjen”, dhe togfjalëshi “bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh”, është hequr fare.

Ndërkohë që, nëse e krahasojmë përmbajtjen e Urdhrit nr. 19, datë 05.05.2021, që Kuvendi, i ka paraqitur si provë shtesë Gjykatës Kushtetuese, në datën 04.02.2022, rezulton se vet përmbajtja e urdhrit, siç evidentuam më sipër, **nuk përputhet as me rendin e ditës që në formë shkresore e shoqëron atë në praktikën e depozituar në Gjykatë.**

Kjo pasi në Rendin e ditës, edhe në variantin që Urdhri i printuar dhe përcjellë shkresërisht i njehsuar nga Kuvendi, citon se: “Në mbështetje të Urdhrit nr. 19, datë 06.05.2021 të Kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi, rendi ditës është si më poshtë vijon:

“20. “Projektvendim “Për miratimin e raportit dhe propozimit të komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra e Presidentit të Republikës”.

Pra edhe brenda të njëjtës praktikë shkresore që Kuvendi i paraqet gjykatës në datë 04.2.2022, në cilësinë e provës, ka harruar të përputhë praktikën shoqëruese, që e nxjerr zbuluar për ndërhyrjet që ka bërë në akt, kur:

- as vetë data e urdhrit që referohet në rendin e ditës bashkëlidhur nuk përputhet me datën që mban urdhri në kopjen shkresore që ka sjellë Kuvendi, (në rend dite nuk referohet data 5, por data 6 maj 2021);

- ashtu si kundër nuk përputhet as përmbajtja e pikës 20 të urdhrit me pikën 20 të rendit të ditës, në dokumentin shkresor që e shoqëron atë.

Ky është veprimi më i rëndë, i Kuvendit, që i dëshpëruar dhe i gjetur në paligjshmëri, tenton deri aty, sa të manipulojë provat që janë bërë publike prej 8 muajsh.

Për më tepër, i duhet rikujtuar Gjykatës Kushtetuese se, Komisioni për çështjet ligjore u mblodh dhe miratoi Raportin që ia përcolli Seancës Plenare, në datën **6 maj 2021**. Ndaj **nuk ka se si Kryetari i Kuvendit, me urdhër të hartuar që në datën 5, për caktimin e rendit të ditës, të dinte se si do të procedonte Komisioni për çështjet ligjore.** Ky fakt është tregues i qartë se versioni i saktë i Urdhrit të Kryetarit të Kuvendit, mban datën 6 maj 2021 dhe është ai i publikuar në faqen zyrtare të Internetit të Kuvendit, me firmë dhe vulë.

Ndërkohë që kopja e përcjellë pranë Gjykatës Kushtetuese nga Kuvendi në datën 4.02.2022, është qartazi e manipuluar, për të mbuluar shkeljet procedurale që ka kryer Kuvendi duke mos respektuar afatin 2 ditor të bërjes publike të Rendit të Ditës e normalisht edhe të dokumenteve që do të shqyrtoheshin në Seancën Plenare.

Kryetari i Kuvendit, jo vetëm që nuk kishte mundësi të dinte vendimmarrjen e Komisionit për çështjet ligjore, e për pasojë që në datën 5 maj 2021, të arrinte të përcaktonte rendin e ditës, por edhe në eventualitetin e një përcaktimi të koordinuar për shkak të situatës së diktuar politikisht, urdhri merr fuqi juridike në datën që protokollohet e që është data 6 maj 2021, datë kjo që nuk ka respektuar afatin 2 ditor që dikton Rregullorja e Kuvendit.

4. Sipas jush, miratimi i Raportit të Komisionit të Çështjeve Ligjore në seancën plenare të datës 7 maj ka shkelur edhe pikën 3 të nenit 112 të Rregullores së Kuvendit. **Jepni shpjegimet tuaja për këtë pretendim.**

Përgjigje: Sipas pikës 3, të nenit 112, të Rregullores së Kuvendit, Seanca Plenare nuk duhet të miratonte asnjë raport të paraqitur nga një komision që nuk kishte përmbushur detyrimin për të dëgjuar Presidentin e Republikës.

Ndërkohë që Kuvendi, edhe për arsye të tjera që i kemi parashtruar (faqe 113 e në vijim të Qëndrimeve të Presidentit të datës 1.7.2021), e dinte fare mirë që po i përfundonte mandati dhe legjitimiteti për të ngritur dhe për të kryer veprimtari hetimore.

Arsye themelore kjo për të cilën seanca plenare duhet të kishte vendosur edhe për këtë shkak rrëzimin/mosmiratimin e Raportit.

5. Ju keni refuzuar të merrni pjesë në seancën **hetimore**, duke pretenduar se keni pasur takime të programuara zyrtarisht me përfaqësues të lartë të vendeve të tjera. **A ka ndodhur në praktikën tuaj që të ndryshoni takimet kur e kanë kërkuar rrethanat? A ka qenë ky shkak për mosparaqitjen tuaj në seancat dëgjimore të zhvilluara nga komisioni hetimor dhe Kuvendi?**

Përgjigje: Pyetja nuk është korrekte. Presidenti më së pari, asnjëherë nuk ka refuzuar takimin, madje ka kërkuar të dëgjohet nga Komisioni për çështjet ligjore, që nuk zhvillon seancë hetimore, siç ju referoni në pyetjen tuaj.

Lutemi t'i referoheni shkresave të datës 5 dhe 6 maj 2021, të Institucionit të Presidentit, ku ka shprehur gatishmërinë për t'u takuar, diskutuar dhe t'u dëgjuar në Komisionin për çështjet ligjore në datën 10 maj 2021, e duke kërkuar caktimin dhe të orës së takimit.

Për më shumë, referojuni shkresave të Presidentit të Republikës nr. 1520/2 Prot., datë 5.5.2021 dhe nr. 1533/2 prot., datë 06.05.2021, dhe qëndrimeve të dorëzuara nga Presidenti i Republikës që në datën 1 korrik 2021 (faqe 88 e në vijim).

Komisioni për çështjet ligjore, në funksion të urdhrit politik, komunikoi në mënyrë ultimative me Presidentin e Republikës, duke i kërkuar që për një çështje kaq të gjerë dhe të madhe, të paraqitej në më pak se 20 orë.

- 6. Një tjetër shkak i pretenduar për refuzimin e paraqitjes suaj në seancat dëgjimore është edhe mungesa e legjitimitetit të strukturave përkatëse të Kuvendit. Ku mbështetet mosnjohja e legjitimitetit të komisionit hetimor, si organ i pushtetit ligjvënës i ngritur sipas ligjit?**

Përgjigje: Mungesa e legjitimitetit e strukturave hetimore të ngritura në Kuvend, ka qenë flagrante dhe është dokumentuar gjerësisht me prova shkresore, dhe në mënyrë të plotë në qëndrimin e Presidentit të Republikës depozituar që prej datës 1 korrik 2021, përpos parashtrimeve të tjera, trajtohen edhe më thellësisht në faqen 110 e në vijim, të tyre.

- 7. Jepni argumente të zgjeruara për pretendimin se veprimtaria e komisionit hetimor duhet të kryhet para mbarimit të afatit të mandatit të Kuvendit, përndryshe komisioni humbet legjitimitetin.**

Përgjigje: Argumentet mbi këtë çështje janë të mbështetura në dokumente dhe të trajtuara gjerësisht me prova shkresore, dhe në mënyrë të plotë në qëndrimin e Presidentit të Republikës depozituar që prej datës 1 korrik 2021, në faqen 88, deri në faqen 130, të tij.

- 8. Pse mendoni se ngritja e komisionit hetimor nuk përputhet me funksionin dhe qëllimet e kontrollit parlamentar të parashikuar në nenin 77 të Kushtetutës?**

Përgjigje: Komisioni hetimor i cili funksionon duke dhunuar Rregulloren e Kuvendit në çdo pikë të vetën, i cili shkel procedurat në funksion të urdhërimit politik, dhe shkel Kushtetutën, që në nenin 77, pika 3, përcakton qartë se: “3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj”, nuk ka më asnjë diskutim se, ky komision u ngrit dhe funksionoi në mënyrë antikushtetuese.

Për më shumë, referojuni qëndrimit të Presidentit të Republikës depozituar që prej datës 1 korrik 2021, në faqen 118, e në vijim të tij.

Komisioni hetimor nuk mund të ngrihej kurrësi, pasi nuk ekzistonte asnjë shkelje e Kushtetutës, por thjesht dhe vetëm pretendime propagandistike të mazhorancës në Kuvend.

9. Si ka ndërhyrë Kuvendi nëpërmjet komisionit në kompetencat e Presidentit?

Përgjigje: Referojuni qëndrimit të Presidentit të Republikës depozituar që prej datës 1 korrik 2021, në faqen 130- 140, si dhe përgjigjes së dhënë për pyetjen e parë të Kryetares së Gjykatës, znj. Tusha.

10. Si e mbështesni pretendimin se komisioni nuk mund të ngrihej pasi i mungonte objekti?

Përgjigje: Komisioni nuk kishte materie për të hetuar, por kishte vetëm objektiva dhe qëllime politike, për të vënë nën presion dhe shantazh, si dhe për të imponuar vullnetin e tij në veprimtarinë e Presidentit të Republikës.

Kësisoj, vetë Komisioni e gjithë veprimtaria e tij u ngrit e u zhvillua mbi një shkelje flagrante në drejtim të raportit të pavarësisë së plotë të funksionimit të institucioneve në shtetin shqiptar.

11. Si i ka cenuar komisioni hetimor parimet e demokracisë, parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, procesin e rregullt, paanësinë?

Përgjigje: Është e evidente dhe tërësisht e faktuar se në të gjitha fazat procedurale të tentativës për ngritjen e Komisionit Hetimor, shkeljet kanë qenë tepër të rënda dhe të pandreqshme. Kjo është trajtuar gjerësisht në qëndrimin e Presidentit të Republikës depozituar që në datën 1 korrik 2021.

Refuzimi i dëgjimit të Presidentit të Republikës, ka cenuar të drejtën themelore të çdo procesi hetimi, vlerësimi, gjykimi, ku palët kanë të drejtën e padiskutueshme të dëgjohen e të përballen.

Dhunimi i procedurës në funksion të objektivit politik, e evidentuar qartë me prova dhe fakte, ka prodhuar një proces dhe një precedent të rrezikshëm, të dënueshëm, e ndaj të cilit duhet mbajtur një qëndrim i prerë nga Gjykata Kushtetuese në funksion të vendosjes së një standardi

të paprekshëm juridik procedural, e cila është garancia e vetme e respektimit të të gjitha lirive dhe të drejtave të qytetarëve të Shqipërisë nga qytetari i thjeshtë, deri te Presidenti i Republikës.

Nuk mund të shkelet kurrë procedura në funksion të politikës! Kjo bën dallimin esencial të shtetit të së drejtës nga partia- shtet.

12. A kishit mjete ligjore në dispozicion për të kundërshtuar ngritjen dhe funksionimin e komisionit hetimor dhe e vlerësuar t'i përdornit ato? Pas rivënies në funksionim të Gjykatës Kushtetuese dhe fillimit të veprimtarisë së saj, a menduat të përdorni si mjet ligjor ankimin kushtetues në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës?

Përgjigje: Mjetet ligjore në dispozicion janë përdorur të gjitha. Në qëndrimin dhe pretendimet e Presidentit të Republikës, dorëzuar që në datën 1 korrik 2021, është parashtruar objekti i kërimit, baza e qartë kushtetuese dhe ligjore për secilin kërkim, lidhur me çështjen për të cilën Kuvendi investoi në mënyrë antikushtetuese dhe të padrejtë Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë bazë ligjore përfshihet qartësisht edhe nenin 131, i Kushtetutës, që evidenton edhe detyrimet e Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur për gjithçka është ngritur në këtë çështje.

Presidenti nuk mund të përgjigjej apo reagojë ndryshe jashtë natyrës së kësaj çështje të iniciuar nga Kuvendi e të formalizuar vetëm me vendimin nr. 55/2021, që konsiderohet kërkesa e Kuvendit për Gjykatën Kushtetuese.

Presidenti do mund të investonte Gjykatën Kushtetuese me kërkime të tij, vetëm pasi Kuvendi të shprehej me një vendim përfundimtar, dhe jo në fazat e ndërmjetme, kur ende nuk dihej se marrëzia politike do çonte deri në miratimin e vendimit nr. 55/2021.

13. Pretendoni se mes jush dhe Kuvendit është krijuar një konflikt kompetencash. A përbën ky një pretendim të ri dhe a mund të ngrihet në këtë lloj gjykimi? Kuvendi parashtron se ju keni përdorur "kundërkërkesën" si mjet procedural, ndërkohë që ai nuk njihet në këtë lloj gjykimi. Keni komente për këtë?

Përgjigje: E tërë vendimmarrja e Kuvendit, përfshirë këtu dhe shkeljet flagrante procedurale, janë udhëhequr thjesht dhe vetëm nga objektivat politike antikushtetuese, me qëllimin e vetëm kufizimin maksimal të ushtrimit të rolit të Presidentit në funksion të paralizimit të veprimtarisë së tij. Pra, politika ka imponuar shkeljet e Kushtetutës dhe ligjit, duke krijuar një situatë shumë të rëndë ndërinstitucionale.

Ndaj përveç sa sqaruar në pyetjen pararendëse, ri përsërisim edhe një herë se, Presidenti ka përdorur të gjitha mjetet ligjore procedurale në dispozicion.

Presidenti nuk mund të përgjigjej apo reagojë ndryshe jashtë natyrës së kësaj çështje të iniciuar nga Kuvendi e të formalizuar vetëm me vendimin final nr. 55/2021, që konsiderohet kërkesa e Kuvendit për Gjykatën Kushtetuese.

Konstatimi dhe evidentimi i kësaj mosmarrëveshjeje u krye në periudhën fundore të veprimtarisë së Komisionit Hetimor dhe që u formalizua me raportin e këtij komisioni në datën 9.6.2021.

- 14. E drejta për t'u dëgjuar a e nënkupton praninë fizike në seancën dëgjimore apo ajo mund të konsiderohet e ushtruar me anë të parashtrimeve të paraqitura me shkrim? Kemi parasysh se në komunikimet me Kuvendin ju keni parashtruar se keni dhënë argumente shteruese me shkresën tuaj nr. 1651, datë 16.05.2021. **A lidhet ky konfirmim me të drejtën tuaj për t'u dëgjuar?****

Përgjigje: E drejta për t'u dëgjuar është një e drejtë kushtetuese e patjetërsueshme!

Kjo e drejtë themelore, është sanksionuar qartë jo vetëm në Kushtetutë, por edhe në Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin për komisionet hetimore.

Refuzimi nga Komisioni për çështjet ligjore të Kuvendit të Shqipërisë, i cili është dhe momenti procedural kur kjo e drejtë realizohet, është një provë e pakundërshtueshme se objektivi politik dhe qëllimet politike, ishin të gatshme të dhunonin Kushtetutën dhe ligjin në funksion të realizimit të qëllimit të tyre.

Në shkresën që ju referoni me nr. prot. 1651, datë 16.05.2021, Presidenti i Republikës i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, duke tërhequr vëmendjen e duke i kërkuar atij që të mbrojë institucionin e Kuvendit të Shqipërisë, që ai të mos bëjë pre e qëllimeve politike duke shkelur rëndë Kushtetutën dhe ligjin.

I ka tërhequr vëmendjen gjithashtu që Kuvendi i Shqipërisë të mos përdorej si një mjet konsumi në funksion të politikës dhe propagandës së ditës, në situatën e ngarkuar pas zgjedhjeve të 25 prillit 2021, por të përmbushte veprimtarinë e tij vetëm duke respektuar pikë për pikë e germë për germë Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin për komisionet hetimore.

Presidenti gjithashtu ka kërkuar që ky respektim i Kushtetutës dhe i ligjit, ishte domosdoshmëri absolute për të shmangur konfliktin e rëndë institucional, i cili prodhonte vetëm kosto për qytetarët, vendin, dhe institucionet e tij.

Pra mesazhet e Presidentit në këtë letër janë të qarta, parimore dhe në përputhje të plotë me rolin e tij si garant i Kushtetutës dhe i funksionimit unitar të shtetit në harmoni dhe në respekt të ndërsjellë të institucioneve pjesë e tij.

Është shumë e qartë dhe e pa ekuivok se pas refuzimit nga Komisioni për çështjet ligjore të Kuvendit për të dëgjuar Presidentin e Republikës në datën 10 maj 2021, gjithçka, çdo hap i mëtejshëm procedural dhe çdo vendimmarrje, ishte haptazi antikushtetuese dhe antiligjore, dhe nuk mund të zëvendësoje apo kompensonte një shkelje themelore jo vetëm të lirive të individit, por dhe të respektit ndaj autoritetit publik që Presidenti përfaqëson dhe ushtron, por edhe të rregullave e procedurave të miratuara nga vetë Kuvendi.

Ndaj refuzimi i kësaj të drejte nga Kuvendi dhe mesazhi i Presidentit të Republikës i datës 16 maj 2021, janë dy çështje krejtësisht të ndara që as kompensojnë, as zëvendësojnë njëra-tjetrën.

Çdo tentativë për të kompensuar, apo minimizuar një shkelje flagrante, themelore, është thjesht dhe vetëm një shërbim në drejtim të antikushtetutshmërisë së të gjithë veprimeve, hapave dhe procedurave të ndjekura për këtë çështje.

15. A mendoni se nëse do paraqiteshit në seancën dëgjimore dhe do të paraqisnit argumente në kundërshtim me argumentet e Komisionit Hetimor, Kuvendi do të kishte marrë një vendim të ndryshëm?

Përgjigje: Vendimmarrja e Kuvendit ishte e parapërgatitur, paravendosur, dhe diktuar politikisht.

Prova për këtë është refuzimi i kërkesës dhe të drejtës së Presidentit të Republikës për t'u dëgjuar në Komisionin për çështjet ligjore.

Pra, mazhoranca e Partisë-Shtet në revanshin për të uzurpuar edhe institucionin e Kreut të Shtetit, refuzoi kërkesën e Presidentit për t'u dëgjuar, pasi ishte shumë e qartë se, kjo do të dërrmonte publikisht të gjithë farsën e parapërgatitur.

Për më shumë, referojuni materialit të depozituar që prej datës 1 korrik 2021.

16. Si e vlerësoni faktin që komisioni hetimor zgjodhi datën e fundit nga datat e propozuara (19-24 maj)?

Përgjigje: Të gjitha datat, 19, 24 maj, apo çdo datë tjetër, janë data të një veprimtarie antikushtetuese. Pra si të tilla, pa asnjë vlerë.

E gjithë veprimtaria dhe e gjithë periudha brenda së cilës ka vepruar Komisioni Hetimor është nul, që nga momenti kur Komisioni për çështjet ligjore, në dhunim të Rregullores së Kuvendit, refuzoi të dëgjonte Presidentin e Republikës në 10 maj 2021.

Për më tepër, referojuni materialit të Presidentit të Republikës depozituar që në datën 1 korrik 2021.

17. A mendoni se mosparaqitja juaj për t`u dëgjuar para komisionit dhe seancës plenare a mund të ketë ndikuar në arritjen e përfundimit nga Kuvendi se ju keni kryer shkelje të rënda?

Përgjigje: Komisioni Hetimor dhe Seanca Plenare në funksion të tij, përbëjnë dy momente të rënda antikushtetuese dhe antiligjore. Kjo sepse, që nga akti publik i refuzimit të dëgjimit të Presidentit të Republikës nga Komisioni për çështjet ligjore është e qartë për çdo jurist se i gjithë ky proces politik dhe antikushtetues, ishte i paligjshëm dhe i paravendosur.

Për më tepër, referojuni materialit të Presidentit të Republikës depozituar që në datën 1 korrik 2021.

18. Në prapësimet tuaja referoni shkelje të nenit 27, pika 5 të Rregullores së Kuvendit në lidhje me caktimin e rendit të ditës. A vazhdoni t'i qëndroni kësaj reference?

Përgjigje: Patjetër që vijojmë t`i qëndrojmë këtij pretendimi!

Përgjigja për këtë pyetje është shteruar plotësisht në përgjigjen e pyetjes nr. 3, të gjyqtarit relator, z. Përparim Kalo.

19. Ju pretendoni se Kuvendi, edhe pse është njohur me prapësimet e datës 1 korrik nuk ka paraqitur asnjë material, pretendim ose qëndrim deri në datën 9 shtator (2021), data e përfundimit të mandatit të tij. Ju pretendoni, gjithashtu, se Gjykata Kushtetuese nuk arriti të shqyrtonte brenda asaj date çështjen që legjislatura IX kishte investuar me vendimin e saj nr. 55/2021. Sipas jush, Kuvendi ka shkelur, gjithashtu, edhe afatin e caktuar nga Gjykata, data 5 nëntor, për paraqitjen e argumenteve shtesë. Për këtë arsye ju pretendoni se Gjykata Kushtetuese do të tregonte anësi nëse pranon vazhdimin e gjykimit. Mund t'i shprehni më qartë këto pretendime?

Përgjigje: Lidhur me këtë pyetje gjithçka kemi paraqitur, janë fakte dhe jo pretendime.

Është fakt që Legjislatura e IX-të e Kuvendit të Shqipërisë, pasi është njohur me qëndrimin e Presidentit të Republikës të datës 1 korrik 2021, **NUK ka paraqitur** asnjë material kundërshtues deri në datën 9 shtator 2021, datë kur i përfundoi mandati kushtetues.

Është fakt gjithashtu se, Kuvendit (Legjislatura e X-të), ka shkelur edhe afatin e caktuar nga Gjykata Kushtetuese, datë 5 nëntor 2021, për të paraqitur argumente shtesë.

Është fakt gjithashtu se, Gjykata Kushtetuese, nuk arriti të shqyrtonte çështjen brenda datës 9 shtator 2021, duke shkelur nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

20. A e keni zbatuar detyrimin kushtetues për të qenë super partes gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021?

Përgjigje: E gjithë veprimtaria e Presidentit të Republikës, ka qenë një dëshmi e qartë dhe publike e qëndrimit mbi palët.

Presidenti i Republikës jo vetëm publikisht, por dhe me të gjitha instrumentet ligjore, ka sensibilizuar fort institucionet shtetërore dhe forcat politike për realizimin e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm, të barabartë dhe pa presione.

Ai kurrë nuk ka mbështetur asnjë subjekt politik garues në zgjedhje dhe ka qenë shumë kritik, qoftë ndaj Partisë në Pushtet, ashtu dhe ndaj Opozitës, për çdo qëndrim që binte ndesh me respektimin e parimeve të demokracisë dhe procesit zgjedhor të rregullt dhe demokratik.

Të gjithë i mbajnë mend kritikën e vazhdueshme dhe publike të Presidentit të Republikës edhe ndaj veprimeve tejet të gabuara të liderit të opozitës për praktikën e bojkotit në përgjithësi, bojkotin e Reformës në Drejtësi në mënyrë të veçantë, e sidomos përgjegjësinë historike për djegien e mandateve të deputetëve, apo për mospjesëmarrjen si në zgjedhjet vendore të 30 qershorit, ashtu dhe mos regjistrimin në veçanti për zgjedhjet e 13 tetorit nga Partia Demokratike.

Po kështu, nxitja e Presidentit për arritjen e marrëveshjes së 5 qershorit dhe nxitja e tij për të nënshkruar dhe respektuar këtë marrëveshje me çdo çmim, ka qenë e evidentuar publikisht.

Madje, edhe paralajmërimi publik i Presidentit të Republikës, se nëse opozita nuk nënshkruante marrëveshjen e 5 qershorit, zgjedhjet do të bëheshin edhe pa të.

Zgjedhjet e 25 prillit 2021, dhe zhvillimet që paraprinë ato, provuan qartë shqetësimet e qëndrimet shumë të drejta të Presidentit të Republikës, e që konfirmohen edhe në Raportin përfundimtar të OSBE/ODHIR-it.

Angazhimi i Presidentit për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe parandalimin e ngjarjeve të rënda për shkak të prekjes së votës, janë të evidentuara qartë.

Të gjitha faktet shkresore dhe dokumentet që e provojnë këtë katërcipërisht u janë vënë në dispozicion së bashku me materialin e datës 1 korrik 2021, ashtu dhe në seancën gjyqësore të datës 3.2.2022.

I kujtojmë Gjykatës Kushtetuese se, nuk ka patur asnjë shqetësim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucioni që sipas Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, është administrator dhe realizuesi i vetëm i proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Ky rol “super partes” i cituar sipas pyetjes suaj, konfirmohet edhe nga vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili përmes shkresës nr. 4378/1 prot., datë 24.04.2021, ka garantuar që 19 anëtarëve të stafit të Kabinetit të Presidentit të Republikës, t`u njihet e drejta për të marrë informacion për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor direkt në qendrat e votimit dhe vendet e numërimit të votave, sipas kërkesës së Presidentit të Republikës nr. 1479 prot., datë 24.4.2021.

Bashkëlidhur gjeni kopjen e shkresës nr. 4378/1 prot., datë 24.04.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

21. Si e vlerësoni formulën e betimit dhe a mendoni se i keni respektuar detyrimet që përmban ajo, sidomos në lidhje me garantimin e statusit neutral e moderues midis forcave politike?

Përgjigje: Presidenti i Republikës, ka patur në vijimësi një qëndrim shumë të qartë të konfirmuar e të provuar shkresërisht për një status moderues, paqtues, dhe konstruktiv, midis forcave politike, pa mbivlerësuar e nënvlerësuar asnjë subjekt politik dhe duke patur si moto të tij barazinë e tyre përpara ligjit, dhe respektimin e parimeve të demokracisë dhe vlerave më të larta morale dhe shoqërore.

Presidenti i Republikës ka ndërmarrë disa herë iniciativa drejtuar të dyja palëve për të bashkëpunuar për zbatimin e Reformës në Drejtësi, në respekt të Kushtetutës.

Presidenti i Republikës publikisht ka ndërmarrë disa iniciativa për platforma për të nxitur procesin e bashkëpunimit në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Presidenti i Republikës ka ndërmarrë iniciativa zyrtare për të shmangur përplasjen lidhur në situatën e zgjedhjeve të 30 qershorit dhe për të caktuar një datë gjithëpërfshirëse me qëllim garantimin e paqes sociale në vend dhe garantimin e së drejtës themelore të votës. Këto janë fakte publike, me të cilat gjykata është njohur edhe nga procese të tjera.

Edhe gjatë situatës së rëndë të pandemisë, Presidenti ndërmori iniciativa gjithëpërfshirëse në funksion të paqes, qetësisë dhe ruajtjes së shëndetit të qytetarëve, duke zhvilluar disa mbledhje të Këshillit të Sigurimit me pjesëmarrjen edhe të opozitës jashtë parlamentare, për të shmangur instrumentalizimin e pandemisë për qëllime politike nga secila palë.

Gjatë periudhës së pandemisë, në 8 prill, pas konsultimeve me kryetarin e Partisë Demokratike, z. Basha, Presidenti i ka paraqitur platformë² për integrimin evropian Kryeministrit, përmes ambasadores së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, e cila synonte garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës për çështjet më kyçe që kishin të bënin me detyrimet e Shqipërisë për çeljen e negociatave me BE-në.

Si përgjigje ndaj përkushtimit të Presidentit të Republikës për të nxitur këtë bashkëpunim, qeveria ndërmori aktin brutal të shkatërrimit të Teatrit Kombëtar në mes të natës së 17 majit 2020, gjatë periudhës së pandemisë, dhe kur zbatoheshin kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur.

Për të shmangur jo vetëm shkatërrimin e Teatrit Kombëtar si një pasuri me vlera të jashtëzakonshme, por edhe pasojat e një konflikti midis ndërhyrjes së dhunshme të policisë ndaj artistëve dhe shoqërisë civile, Presidenti ndërmori iniciativën për t'u paraqitur vetë në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që të frenonte ardhjen e atyre pasojave të cilat u bënë fakt i kryer në 17 maj 2020, dhe që i di gjithë opinioni publik, vendas dhe ndërkombëtar, ashtu si dhe anëtarët e trupit gjykues.

Iniciativat e Presidentit kanë qenë të panumërta për të frenuar konfliktet, për të respektuar parimet e shtetit të së drejtës nga secila palë, për të mos u cenuar stabiliteti i vendit dhe kredencialet e tij demokratike, dhe për të mos ngrirë procesin e çeljes së negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Presidenti, e ka ruajtur këtë qëndrim edhe kur është vendosur përpara trysnisë nga partia në pushtet dhe bërja e saj një me shtetin përmes sulmeve të saj.

Megjithatë për kujtesë: **Në datën 10 mars 2021**, kur Partia Socialiste zhvilloi një aktivitet publik politik, ku prezantoi kandidatët e saj për zgjedhjet e 25 prillit, Kryeministri/Kryetar i Partisë Socialiste Edi Rama, në prezantimin publik të kandidatëve për deputetë, Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë, e **krahasoi si kandidatë me Presidentin e Republikës, duke i dhënë Presidentit cilësinë e deputetit apo kandidatit për zgjedhje.**

Duke i vendosur të dy fotot e zonjës Gjonaj dhe Presidentit Meta në ekran Edi Rama, komentonte se:

“Urdhëro me kë fiton drejtësia? Mos më thoni që ky nuk është deputet³! Ky është kryedeputeti i asaj skuadre...⁴. Dhe sot në kushtet kur flasim ky është akuzuesi dhe kjo është

² Për më shumë, lutemi t'i referoheni link-ut vijues:

<https://president.al/platforma-e-presidentit-te-republikes-per-integrimin-evropian-te-shqiperise/>

³ I referohet fotos së Presidentit Meta.

⁴ <https://fb.watch/65XxoVauyF/>

<https://president.al/deklarate-per-mediat-e-presidentit-te-republikes-sh-t-z-ilir-meta-6/>

<https://www.youtube.com/watch?v=5YVR-6PPvmg>

e akuzuara e këtij. Parafytyroni tani, sikur në 25 prill , të mos zgjidhet kjo, por të zgjidhet ky⁵.

Një provë tjetër skandaloze e sulmit të mazhorancës ndaj Presidentit të Republikës, evidentohet në këto foto që tregojnë posterat propagandistike të vendosur në vende publike nga Partia Socialiste në qytetet Gjirokastrë, Durrës dhe Tiranë, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit Zgjedhor.



Vendosja e këtyre materialeve propagandistike është tregues i qartë i sulmit të drejtpërdrejtë ndaj Presidentit nga qeveria dhe ndikimit politik të qeverisë ndaj strukturave të Policisë së Shtetit, Drejtorive Vendore të Policisë të këtyre qyteteve, si dhe ndaj bashkive Gjirokastrë, Tiranë, Durrës etj., të cilat edhe pse ishin përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe realizimin e disa detyrave të rëndësishme që lidhen me këto çështje të procesin zgjedhor, nuk ndërmorën masat

⁵ I referohet sërish Presidentit Meta, në foton e shfaqur në ekran.

e duhura për përmbushjen e tyre, sipas ligjit dhe kanë demonstruar anësi të qartë në favor të qeverisë.

Edhe për këtë fakt, Presidenti i Republikës, në datë 19 prill 2021, bëri denoncimin e tij pranë organeve ligjzbatuese, për të hetuar në lidhje me autorët e prodhimit dhe vendosjes së këtij materiali propagandistik me përmbajtje fyese dhe jashtë kriterëve dhe kërkesave të Kodit Zgjedhor, ashtu sikundër edhe ndaj personave të tjerë, që kanë mbështetur vendosjen e këtij materiali dhe reklamimin e tij, si dhe për të gjithë ata funksionarë publikë që përmes mosveprimit kanë shpërdoruar detyrën që u ngarkonte ligji.

Për më tepër, lutemi t'i referoheni faqes 66, 70, dhe 97-103 të qëndrimit të Presidentit të Republikës të dorëzuara që prej datës 1 korrik 2021.

- 22.** Deri ku shtrihet e drejta e fjalës/shprehjes e Presidentit, duke vlerësuar njëkohësisht pozicionin e tij neutral - tipik për republikat parlamentare. A mund të përdoret e drejta e fjalës si një mjet kushtetues në mbrojtje të veprimeve të kryera nga funksionarët e lartë publikë?

Përgjigje: Edhe në periudhën që lidhet me zgjedhjet e 25 prillit, Presidenti ka qenë i vetmi aktor institucional që ka mbrojtur realizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme dhe jashtë çdo presioni të çfarëdolloj forme.

Të gjitha mesazhet e Presidentit, kanë patur si fokus, realizimin e zgjedhjeve pa tension, pa dhunë, si mundësi e realizimit të së drejtës themelore të shprehjes me votë të lirë nga çdo qytetar, në respekt të Kodit Zgjedhor dhe gjithë legjislacionit që ka lidhje me proceset zgjedhore.

Presidenti i ka qëndruar përherë besnik respektimit të Kushtetutës, mbrojtjeve të parimeve, të drejtave dhe lirive themelore, të qytetarëve dhe ka tërhequr vëmendjen ndaj kujtdo aktori politik apo shtetëror që është përpjekur t'i atakojë apo t'i cenojë ato.

- 23.** Si e realizon Presidenti rolin e përcaktuar në Kushtetutë (neni 86) si përfaqësues i unitetit të popullit?

Përgjigje: Presidenti e realizon këtë rol, në mbështetje të Kushtetutës, të ligjeve të vendit, të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me rolin dhe pozitën që Kushtetuta i ka dhënë.

Në funksion të këtij roli, Presidenti ka shprehur shqetësimet e tij, ndaj gjithë institucioneve shtetërore dhe subjekteve politike, sa herë që ai ka konstatuar që ata kanë dalë jashtë kornizës

së Kushtetutës dhe ligjit, me veprimtarinë e tyre, dhe veçanërisht në periudhën e zgjedhjeve ku situata politike shoqërore në vend u rëndua së tepërmi.

Presidenti, inkurajoi dhe nxiti organet ligjzbatuese që të vepronin me përparësi, ndaj ngjarjeve tragjike si ajo e Elbasanit, ku për fat të keq pati dhe humbje jete, të Kavajës, Fierit, me qëllimin e vetëm parandalimin e përshkallëzimit të tensionimit të situatës që do të komprometonte rëndë procesin zgjedhor dhe paqen sociale.

Është fakt se në të gjitha rastet e këtyre konflikteve, shkaktarët i përkisnin mazhorancës. Ashtu siç është fakt se këto ngjarje erdhën si rezultat i mos hetimit në kohë të denoncimeve të bëra për elementë të përfshirë në krime zgjedhore, si rezultat i mosveprimit në kohë nga ana e policisë dhe institucioneve ligjzbatuese për të ndaluar elementët kriminalë, dhe mbështetjes politike që këta elementë gëzonin, e që është e provuar publikisht.

24. A përfshihet kontrolli ose orientimi i veprimtarisë së prokurorisë në kuadrin tuaj të kompetencave kushtetuese, kur kemi parasysh përcaktimin e saj si institucion i pavarur në nenin 148 të Kushtetutës?

Përgjigje: Bashkëpunimi me prokurorinë për probleme që përbëjnë shqetësim madhor publik e për të cilat Presidenti është vënë në dijeni, është një bashkëpunim kushtetues dhe i ligjshëm.

Në respekt të plotë të pavarësisë së institucioneve respektive, veçanërisht sa i takon krimeve zgjedhore e autorëve të tyre, Institucioni i Presidentit të Republikës ka komunikuar edhe me organin e prokurorisë, veçanërisht sa i takon krimeve zgjedhore dhe autorëve të tyre.

Shqetësim madhor i Presidentit ka qenë hetimi me prioritet i krimeve zgjedhore, mos cenimi i votës dhe dekurajimi i tensionimit ekstrem të situatës.

Koha ishte e kufizuar dhe kërkonte përparësi në trajtimin e këtyre problematikave për parandalimin e kryerjes dhe të ardhjes së pasojave nga veprat penale apo veprimtaria e paligjshme.

25. A kanë pasur qytetarët mjete ligjore në dispozicion përgjatë periudhës që ka qenë objekt hetimi nga komisioni hetimor? A është evidentuar dikush që të ketë pasur pengesa për të ushtruar të drejtën e përdorimit të mjeteve përkatëse?

Përgjigje: Qytetarët shqiptarë, ashtu sikurse është provuar botërisht, janë vendosur përpara trysnisë së partisë në pushtet, provuar kjo me sistemin e patronazhimit ndërtuar mbi vjedhjen e të dhënave personale dhe mbikëqyrjen përmes patronazhistëve.

Haptazi, qytetarëve, këto të drejta u janë dekurajuar përmes këtyre formave të presionit dhe shantazhit, duke detyruar që shumë aktorë institucionalë, politikë dhe të shoqërisë civile, të aktivizojnë instrumente transparente për denoncimin masiv të krimit zgjedhor, me qëllim minimizimin e efekteve shkatërrimtare të tij mbi zgjedhjet e lira dhe të ndershme.

26. Sipas nenit 132 të Kushtetutës vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme dhe nuk mund të vihen në diskutim nga asnjë organ i shtetit, madje as prej vetë asaj. Gjithashtu, Gjykata është organi i vetëm i veshur me kompetencën e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës dhe të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjit. Ndërkohë që Gjykata ka përballuar një vit pune intensiv e tejet të ngarkuar Presidenti ka vënë në diskutim publikisht vendime të saj, madje ka shprehur edhe vlerësime për gjyqtarët e saj nisur nga vendimmarrja e tyre. Mendoni që ky qëndrim përfshihet në kompetencat dhe të drejtën e shprehjes së Kryetarit të shtetit?

Përgjigje: Presidenti i Republikës ka zbatuar çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese. Nuk ekziston asnjë rast i vetëm ku ai të ketë refuzuar zbatimin e këtyre vendimeve.

Madje Presidenti ka qenë konsekuent dhe parimor në qëndrimin e tij, për një drejtësi larg presioneve politike, gjë që, ai edhe në shkresën drejtuar Gjykatës Kushtetuese se, shprehimisht thotë:

“Lidhur me këtë ju garantoj se, si President i Republikës, do të ofroj të gjithë mbështetjen time, në dhënien e drejtësisë kushtetuese, për ta mbajtur Gjykatën Kushtetuese larg presioneve politike, edhe pse aktualisht pjesa tjetër e strukturës kryesore të shtetit (si parlamenti dhe qeveria) jo vetëm që nuk angazhohen për mirëfunksionimin dhe mbrojtjen e rendit juridik të shtetit tonë, por kanë bërë dhe po bëjnë çdo gjë, si përmes procesit legjislativ, ashtu dhe keq qeverisjes, duke vënë në rrezik permanent në shumë raste interesat kombëtare, interesin publik, sovranitetin e vendit dhe pluralizmit politik, e duke e kthyer vendin tonë, në një vend ku demokracia të njihet vetëm në letër, ndërsa në praktikë të ekzistojë një regjim autokratik një partiak.”

Në Republikën e Shqipërisë asnjë institucion nuk mund të dalë jashtë sistemit demokratik të llogaridhënies, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj edhe në Kushtetutë është parashikuar procedimi disiplinor edhe i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, apo të Gjykatës së Lartë, për të rritur ndjenjën e përgjegjësisë, dhe për të garantuar edhe llogaridhënien e tyre përpara Kushtetutës dhe ligjit.

Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese ka karakter suprem në Republikën e Shqipërisë, por të mos harrojmë se jemi anëtarë të shumë konventave ndërkombëtare dhe evropiane, dhe i nënshtrohemi detyrimeve ndërkombëtare dhe juridiksionit të gjykatave ndërkombëtare.

Prandaj çdo vendim i sistemit tonë gjyqësor që dështon në dhënien e drejtësisë, e shkakton pasoja serioze për shtetin e qytetarët (*mjafton të kujtojmë penalitetet për Shqipërinë në gjyqet*

e arbitrazhit ndërkombëtar), ngarkon me përgjegjësi edhe autoritetet që kanë shqyrtuar çështjet jashtë standardeve evropiane.

Lidhur me këtë pyetje, mund të sjellim një përgjigje të vetë Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë, lidhur me kritika publike të Presidentit të atij vendi. Në Opinion Këshillimor nr. 1, të datës 5 prill 2007, botuar në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 258, datë 18.04.2007, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë, mes të tjerash është shprehur se⁶:

“Referuar fakteve të sipërcituara, që i ngarkohen Presidentit të Rumanisë, nuk mund të pretendohet se ai ka shkelur parashikimet mbi pavarësinë e gjyqësorit duke bërë kritika ndaj magjistratëve, përfshirë ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. [...]”

27. Çfarë raportesh duhet të ruajë Presidenti me institucionet e ngritura dhe që funksionojnë sipas Kushtetutës dhe ligjeve, përfshirë KQZ-në, Prokurorinë dhe Gjykatën Kushtetuese? A mendoni se aktet dhe qëndrimet tuaja kanë qenë në mbështetje të veprimtarisë së tyre të pavarur? A është deklarata juaj “mos e detyroni popullin t’ju arrestojë në flagrancë përmes ligjit” e pranueshme si mjet komunikimi?

Përgjigje: Presidenti i Republikës, ka patur një komunikim të vazhdueshëm dhe intensiv me të gjitha institucionet e pushtetit ekzekutiv apo të sistemit të drejtësisë, për çështje që lidhen me respektimin e Kushtetutës, zbatimit të ligjit, e në mënyrë të veçantë për problemet që lidhen me krimin zgjedhor dhe garantimin e proceseve për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Ai ka mbështetur institucionet e pavarura, që ato të ruajnë integritetin e tyre, përballë presionit të ekzekutivit, i ka inkurajuar të veprojnë sa më shpejt, për të parandaluar agravimin e situatave, dhe të kenë si busull udhëheqëse ligjin dhe vetëm ligjin!

Në çdo deklaram të Presidentit, qoftë ky formal, apo përmes mesazheve publike të çdo lloji, gjithmonë referencë ka qenë Kushtetuta dhe Ligji!

Ndërkohë që, janë vërtetuar dhjetra e dhjetra shkelje të ligjit e të Kushtetutës nga qeveria, ndaj të cilave Presidenti ka reaguar jo vetëm me kthimin ligjeve, por edhe me vënien në lëvizje të institucioneve të drejtësisë, sipas problematikave përkatëse.

Në komunikimin me institucionet e pavarura dhe kushtetuese, nuk ka patur asnjë rast të vetëm (përveç Kuvendit) që këto institucione të kenë shprehur ndonjë pretendim, apo shqetësim lidhur me komunikimet e ndërsjella me Institucionin e Presidentit të Republikës.

⁶ Burimi i këtij citimi, përkthyer nga ana jonë: <https://legislatie.just.ro/Public/DetaliiDocument/81245>

28. Daljet publike dhe deklaratat në medie janë bërë me kërkesë të gazetarëve ose televizioneve përkatëse apo janë kërkuar prej jush? Në ç`mënyrë qëndrimet publike e medie me kritika të ashpra ndaj qeverisë, të shoqëruara shpeshherë me epitete për të dhe funksionarë të saj, do t'i shërbente mbrojtjes së interesit të përgjithshëm?

Përgjigje: Kërkesat e gazetarëve të televizioneve për intervista apo deklarata publike, janë shumë herë më të mëdha nga mundësitë e Presidentit për t`iu përgjigjur.

Opinionet e Presidentit në mbrojtje të Kushtetutës dhe ligjit, nuk duhet të censurohen nga kurrkush. Kushtetuta dhe ligjet krijojnë të gjithë hapësirën që mundësia e fjalës së lirë dhe pa censurë, t`i garantohet edhe qytetarit më të thjeshtë, e jo më Presidentit të Republikës.

Natyrshëm, forma, argumentimi, tonaliteti, ngjyrimi individual, apo emocional, janë në mënyrë të padiskutueshme të drejta të patjetërsueshme të ushtrimit të lirisë së fjalës, në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe atij kombëtar, respektit ndaj Kushtetutës dhe Ligjit, që kanë qenë dhe mbeten thelbi i përmbajtjes së çdo komunikimi publik të Presidentit të Republikës.

29. A konsiderohen thirrjet publike të Presidentit para dhe gjatë fushatës si mjete të përshtatshme për mbrojtjen e votës?

Përgjigje: Thirrjet e Presidentit për mbrojtjen e votës, janë një kontribut i shtuar lidhur me problemin shumë të rëndë të garantimit të votës së lirë dhe shmangien e rrezikut të shitblerjes së saj, si fenomene që kanë tronditur rëndë institucionin e votës së lirë në Shqipëri, duke filluar me ngjarjen në Dibër në 2016, zgjedhjet e 2017-ës, të 2019-ës, dhe që ishin fenomene masive të certifikuar edhe zyrtarisht nga OSBE/ODHIR në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Shqetësimet madhore për problemet serioze të zgjedhjeve janë ngritur në të gjitha raportet e OSBE/ODHIR-it, dhe në këtë frymë Presidenti i Republikës, duke vlerësuar shumë seriozisht besueshmërinë e këtyre raporteve, ka orientuar dhe fokusuar mesazhet e tij që lidhen me ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

30. Keni përmendur shpesh “popullin e 2 marsit”. Cila është sipas jush kjo kategori, duke vlerësuar pjesëmarrjen e popullit në zgjedhje dhe rezultatet zyrtare të KQZ- së për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe votat e marra nga shumica qeverisëse.

Përgjigje: Populli i 2 marsit, përfaqëson të gjithë shqiptarët, të cilët duan të qeverisen vetëm nga Kushtetuta dhe ligji, që duan demokracinë dhe jo autokracinë, dhe nuk duan t`i nënshtrohen asnjë abuzuesi dhe shkelësi të ligjit, qoftë ky Kryeministër, ministër, funksionar publik apo politik, i çdo lloji a niveli qoftë.

Populli i 2 marsit është ai që i vuri gjoksin mbrojtjes së Kushtetutës dhe mbështeti Presidentin e Republikës, duke frenuar mazhorancën që të instalonte formatin e “*betimit të gjykatësve kushtetues tek noteri (te Lana)*”; duke parandaluar përdhosjen brutale të shtetit të së drejtës.

Populli i 2 marsit ishte populli që kërkonte ngritjen e Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve vetëm të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Populli i 2 marsit janë të gjithë shqiptarët që duan ta shohin Shqipërinë si vend anëtar të Bashkimit Evropian, ku sundon vetëm shteti ligjor, dhe jo shteti i kapur apo drejtësia me regji (partiake).

Populli i 2 marsit është pa asnjë diskutim, një shqetësim shumë i madh për këdo që shkel Kushtetutën, ligjin, cenon interesin publik e kombëtar, dhe në këtë mënyrë kërkon të abuzojë në kurriz të djersës, mundit, dhe sakrificave të qytetarëve të thjeshtë, të ndershëm e patriotë të vendit tonë.

31. Shprehje të tilla si “ditën e votimeve t’i mprehin sfurqet”, “Lidheni të Marrin”, “regjimit të dhunës edhe tri ditë dhe i vjen fundi përgjithmonë”, “Presidenti, gati për të firmosur dekretin për mbrojtjen e Republikës! Shqipëria e shqiptarëve! Vdekje tradhtarëve!”, “një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti, mjerë ju!”, “ndëshkoni pa mëshirë më 25 prill këdo që ju bën presion me votën, këdo që tenton t’ju blejë votën, këdo që ju ka mashtruar”, “Një votë po u prek, do pritet një dorë”, apo shprehja “të fus në burg”, çfarë qëllimi kanë pasur, duke konsideruar rolin e Presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit, si organ super partes dhe moderues i tre pushteteve të tjera?

Përgjigje: Kjo pyetje mund të jetë e influencuar nga pasojat e propagandës toksike publike të partisë në pushtet, e cila vijon pandërprerë sulmin ndaj Kreut të Shtetit.

Metaforat, epitetet, alegoritë, dhe figurat e tjera letrare, do të ishin objekt interesant debati për gjuhëtarët dhe filologët, por jo për Gjykatën Kushtetuese.

Por në funksion të respektit dhe transparencës me qytetarët shqiptarë, ju kujtoj se fushata e 25 prillit 2021, u tensionua në nivele ekstreme për shkak të aktorëve politikë, duke kulmuar edhe me humbje jete (si ngjarja e Elbasanit), sulme të armatosura (si rasti i Kavajës), e dhjetra ngjarje të tjera deri në situatat shumë të rënda provokative (si ngjarjet e Fierit).

Në një situatë kaq të rëndë, e cila po përshkallëzohej dita- ditës, ishte vetëm Presidenti i Republikës, i cili mbajti qëndrime të vazhdueshme e të njëpasnjëshme, për të dekurajuar këtë përshkallëzim dhe strategji tensioni, si dhe për të vënë në lëvizje institucionet që të vepronin sa më parë me qëllim kryesor parandalimin e pasojave dhe/apo ngjarjeve të tjera të rënda.

Edhe në provokimin e shëmtuar të Fierit, të nxitur nga veprimet e paligjshme e provokative të Bashkisë së Fierit dhe përfaqësuesve të mazhorancës, Presidenti u kërkoi publikisht kandidatëve të një force politike (LSI) të mos binin prë e provokimeve të partisë në pushtet, dhe ta tejkalonin atë situatë me urtësi.

Deklaratat dhe denoncimet publike dhe shkresore të Presidentit të Republikës, kanë qenë plotësisht në proporcion të drejtë me situatën shumë të rëndë parazgjedhore, dhe në funksion të parandalimit të përshkallëzimit dhe daljes jashtë kontrollit të saj.

Keqkuptimi i qëllimshëm, apo dhe pa dashje, i qëndrimeve të Presidentit të Republikës vjen nga zhvendosja e qëllimshme e termave të caktuar nga konteksti i plotë i ngjarjes dhe i rrethanave.

Në mënyrë të veçantë, ajo vjen nga ngatërrimi i qëllimshëm i “kushtores” me “kushtrimin”. Mjafton të harrohet, apo të hiqet një “nëse”, dhe gjithçka ndryshon si nata me ditën.

Termi “sfurqet” është përdorur në Fier, gjatë një konflikti konkret, duke iu referuar një konflikti që Presidenti i Republikës dikur e ka përjetuar personalisht në Libofshë të Fierit gjatë viti 1994, kur policia dhe banditët u bënë njësh për të dhunuar zgjedhjet, dhe kur gratë e Libofshës u detyruan të rrëmbenin sfurqet për të mbrojtur dinjitetin e tyre dhe të komunitetit ku jetonin.

Presidenti i Republikës në këtë deklaratë, i ka përmendur “sfurqet” si mjete pune të banorëve të zonës.

Është e pakuptueshme se përse duhet të shqetësohej mazhoranca për përmendjen e “sfurqeve”, nëse vërtet nuk synonte të prekte votën e qytetarëve ditën e zgjedhjeve.

Kushdo që do të donte ta shikonte Presidentin pasiv përpara një situatë ku proceset zgjedhore përgjaken nga humbja e jetës së njerëzve, për shkak të presionit të partisë në pushtet por dhe mosveprimit të institucioneve ligjzbatuese, do të thotë që kërkon t'i shërbejë pushtetit të dhunës, dhe jo shtetit ku respektohen liritë dhe të drejtat e qytetarëve.

Kushdo që do të donte ta shikonte Presidentin e Republikës pasiv përpara shpërdorimit të parave publike nga ana e qeverisë për blerjen e votës dhe shantazhimin e qytetarëve e nëpunësve të administratës për votën e tyre, do të thotë që është pro instalimit të diktaturës një partiake dhe varrosjes *de facto* të pluralizmit në Shqipëri.

Kushdo që do të donte ta shikonte Presidentin e Republikës pasiv përpara kësaj situatë, dëshiron që të legjitimohet cenimi dhe asgjësimi i të drejtës kushtetuese për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, bazë për ndërtimin e shtetit demokratik, themeli i të cilit është vota e lirë, e barabartë, dhe e pandikuar.

Aq më tepër kur vendi futet në udhëkryqe tepër të rrezikshme për të tashmen dhe të ardhmen e tij.

Shembujt nuk mungojnë. Është i njohur edhe këtu reagimi i Presidentit Rumun, zoti Klaus Iohannis⁷, të një vendi anëtar të NATO-s dhe vendi anëtar të BE-së.

Presidenti Iohannis, iu bashkua protestës së qindra mijëra qytetarëve rumunë, që protestonin për një ligj që lidhej me konfliktin e interesit, dhe ai e deklaroi publikisht përpara protestuesve se veprimi i qeverisë, ishte fillimi i një grushti shteti.

E mbajnë mend gjithë qytetarët shqiptarë se ligje si ai për të cilin protestoi Presidenti i Rumanisë, miratoheshin çdo seancë në Kuvendin tonë një partiak, sipas listës së 56 ligjeve që ia kemi vënë në dispozicion Gjykatës.



Foto nga prania e Presidentit Klaus Iohannis në shesh me protestuesit

Ky presion publik detyroi qeverinë rumune të kohës të tërhiqte ligjin, dhe askush nuk guxoi ta akuzonte Presidentin Klaus Iohannis, apo ta hetonte për këtë sjellje.

Ky rast demonstroi se kur interesi publik vihet në rrezik, çdo reagim i fortë i Presidentit është një garanci, një mundësi dhe një shpresë, për mbrojtjen e unitetit të shtetit dhe garantimin e interesave të qytetarëve të vendit.

Ndërkohë që në Shqipëri, Presidenti i Republikës, është përballur me një situatë shumë herë më të rëndë se kaq, sepse sulmohej drejtpërsëdrejti Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese, shteti i së drejtës, interesi publik, sistemi i drejtësisë në tërësi, dhe ndarja, pavarësia dhe balanca ndërmjet pushteteve.

⁷ <https://www.cotidianul.ro/ce-vazut-iohannis-dupa-ce-urmarit-cu-foarte-mare-atentie-protestele/>

32. A mendoni që vetëpërbajtja është detyrim për pozicionin kushtetues neutral që ka Presidenti? Për nga mënyra se si janë konceptuar kompetencat e Presidentit nga Kushtetuta, a vlerësoni se Presidenti ka rol kontrollues ndaj pushteteve të tjera dhe nëse po si ushtrohet ai?

Përgjigje: Vetëpërbajtja, qëndrimi institucional, kushtetues, dhe barazlargimi i Presidentit nga forcat politike, kanë qenë karakteristikat thelbësore të sjelljes së Presidentit, i cili është përballur me një situatë botërisht të njohur si anormale, në veçanti pas djegies së mandateve nga opozita, dhe bojkotit të zgjedhjeve vendore, si dhe të Reformës në Drejtësi, pra në kushtet e kapjes së gjithë pushteteve nga partia në pushtet.

Presidenti ka ndërtuar në mënyrë kushtetuese, një rol bashkëpunues dhe respekti ndaj pushteteve të tjera, dhe ka qenë shembulli i vetëm i komunikimit institucional dhe respektit ndaj pavarësisë së tyre.

Nuk ka tentuar asnjëherë Presidenti i Republikës të marrë një kompetencë të qeverisë. Përkundrazi, e kundërta ka ndodhur!

Nuk ka tentuar asnjëherë Presidenti i Republikës të marrë një kompetencë të Kuvendit të Shqipërisë. Përkundrazi, e kundërta ka ndodhur!

Gjithmonë ka qenë Presidenti i Republikës që në mënyrë institucionale, zyrtare, shkresore, ka kërkuar bashkëpunimin e tyre me qëllim parandalimin e konflikteve që mund të ndodhnin e që kanë ndodhur.

Presidenti është vënë gjithmonë para faktit të kryer në të gjitha konfliktet që kanë ndodhur, nga mazhoranca dhe institucionet e kapura prej saj.

Vetëpërbajtja, është relative dhe dinamike. E rëndësishme dhe e domosdoshme është që vetëpërbajtja e Presidentit të Republikës të udhëhiqet nga interesi më madhor i vendit, i mbrojtjes së Kushtetutës, si edhe nga proporcionaliteti që diktohet nga rrethanat konkrete dhe sjelljet e aktorëve të tjerë.

Në funksion të këtij roli, ai ka komunikuar çdo shqetësim të karakterit kushtetues dhe ligjor, që nga kthimet për rishqyrtim të ligjeve me problematika të rënda të karakterit kushtetues, e deri tek përcjellja e denoncimeve të shumta, që lidheshin me krimet zgjedhore dhe abuzimet e qeverisë, në procesin zgjedhor.

Presidenti i Republikës ktheu për rishqyrtim ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor, të 5 tetorit, të cilat reflektonin ndryshimet kushtetuese të 30 korrikut 2020, dhe që përbënin shkatërrimin e konsensusit politik gjithëpërfshirës të 5 qershorit dhe ndryshimeve në rregullat

zgjedhore që ai prodhoi në 23 korrik 2020, **duke u bërë burimi kryesor i tensionit dhe humbjes së besimit midis palëve.**

Të gjitha zhvillimet që pasuan, provuan katërcipërisht drejtësinë e veprimeve dhe akteve të Presidentit të Republikës, sepse realiteti provoi që këto ndryshime të njëanshme, prodhuan destabilizim, tensionim të rëndë të situatës politiko- shoqërore dhe sociale, polarizim ekstrem dhe antagonizëm të theksuar mes forcave politike, ashtu si dhe dëmtim të rëndë të procesit zgjedhor, që u konfirmua dhe nga Raporti Final i OSBE/ODHIR i korrikut të vitit 2021.

33. Gjithashtu, a mendoni se akuzat ndaj përfaqësuesve të misioneve diplomatike bërë në daljet tuaja publike në media apo rrjetet zyrtare e sociale si të korruptuar apo ato për rrezikun e integritetit tuaj fizik kanë bazë faktike dhe nëse po, a keni bërë denoncim në organet përkatëse?

Përgjigje: Në vijimësi dhe në mënyrë të veçantë gjatë periudhës zgjedhore, Presidenti i Republikës ka patur dhe ka një komunikim të shkëlqyer me misionet diplomatike dhe institucionet ndërkombëtare.

Ky komunikim është i evidentuar edhe në provat që kemi dorëzuar dhe kanë qenë me shkrim, nëpërmjet dokumenteve të shumta zyrtare dorëzuar atyre, si dhe takimeve po zyrtare.

Komunikimi është ndërtuar gjithmonë bazuar në respektim të plotë të Kushtetutës, të ligjeve në fuqi, të sovranitetit dhe reciprocitetit.

Presidenti i Republikës ka refuzuar prerë çdo lloj ndërhyrjeje apo qëndrimi publik nga diplomatë të veçantë, të cilët në mënyrë direkte apo të nënkuptuar, kanë mbështetur shkeljet dhe shkelësit e Kushtetutës, shkeljet e njëanshme të marrëveshjes së 5 qershorit 2020, shkeljet e ligjit, marrjen nën mbrojtje të personave nën hetim, dhe cënuesit e integritetit të institucioneve të pavarura (rasti “Dvorani”, por jo vetëm).

Presidenti ka refuzuar prerë çdo ndërhyrje nga aktorë të veçantë të trupës diplomatike, që kanë vepruar në shkelje të hapur të statusit të tyre diplomatik dhe Konventës së Vjenës, duke guxuar t’i diktojnë Presidentit të Republikës se si ai duhet të nxjerrë aktet e tij kushtetuese, edhe duke shkelur Kushtetutën dhe degraduar procesin e emërimeve në Gjykatën Kushtetuese, për të pranuar në heshtje rrëmbimin flagrant të kompetencave të Kreut të Shtetit, me pasojë kapjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe jo vetëm.

Presidenti i Republikës është përballur edhe më parë me ndërhyrjet ilegjitime të disa diplomatëve të caktuar, edhe në procesin e ndërtimit të institucioneve të drejtësisë, bllokimin e pajustificueshëm të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, emërimin antikushtetues me 69 vota të Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm, apo për veprimet manipuluese dhe jo transparente të ish kreut të KED-së lidhur me emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Përballë qëndrimit parimor dhe kushtetues të Presidentit të Republikës, këta diplomatë janë tërhequr dhe kjo ka qenë provë e padiskutueshme e principialitetit të Presidentit të Republikës në çdo situatë.

Presidenti i Republikës ka një marrëdhënie zyrtare plotësisht të dokumentuar dhe tejet konstruktive me partnerët kryesorë të vendit tonë, e në veçanti për Reformën në Drejtësi, sidomos me Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe Britaninë e Madhe.

Këta partnerë gjithmonë janë informuar në kohë, zyrtarisht dhe shkresërisht nga Presidenti i Republikës për përpjekjet e ethshme të qeverisë dhe mazhorancës për kapjen e sistemit të drejtësisë, e sidomos të Gjykatës Kushtetuese, në dhunim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës ka bërë gjithçka për të parandaluar konfliktet publike të cilat ndodhën midis Presidentit dhe Kuvendit, apo KED-së dhe qeverisë, për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilat mund të ishin shmangur plotësisht nëse Presidenti nuk do të ishte vënë para fakteve të kryera, që i kishte paralajmëruar disa herë e në mënyrë të përsëritur se nuk do t'i toleronte.

Presidenti i Republikës i ka tërhequr vëmendjen çdo diplomati që nuk e nderoi respektimin e marrëveshjes 5 qershorit 2020, por me deklarata publike i dhanë alibi mazhorancës për të bërë ndryshime të njëanshme të marrëveshjes së 5 qershorit (ky ishte dhe burimi kryesor i tensionit dhe mosbesimit të palëve në prag të zgjedhjeve).

Presidenti i Republikës kurrë nuk ka marrë asnjë shqetësim zyrtar nga asnjë partner ndërkombëtar për sjelljet apo aktet e tij.

Presidenti, shqetësimet e tij për sjellje jo korrekte të diplomatëve të caktuar, ua ka shprehur zyrtarisht atyre, duke vënë në dijeni po zyrtarisht edhe vendet apo organizatat që ata përfaqësojnë.

Presidenti i Republikës nuk ka ndërhyrë kurrë në kompetencat e asnjë përfaqësie diplomatike dhe të asnjë vendi partner, por për fat të keq, ka patur diplomatë të caktuar që publikisht kanë vënë në diskutim dekretet e Presidentit, duke marrë hapur anën e mazhorancës në kapjen e sistemit të drejtësisë, e sidomos të Gjykatës Kushtetuese.

Janë të njohura opinionet e Komisionit të Venecias për këto çështje, ku të gjitha aktet e Presidentit janë vlerësuar të drejta, legjitime, të arsyeshme, dhe janë evidentuar qartë edhe shkaktarët e këtyre konflikteve.

Ky pozicion i Presidentit të Republikës nuk do ndryshojë absolutisht, as edhe një milimetër, edhe në të ardhmen, pasi zbatimi i Kushtetutës, interesit kombëtar dhe interesit të shqiptarëve, janë të shenjta dhe të paprekshme nga asnjë aktor vendas apo i huaj.

Përpos këtyre fakteve, lutemi studioni me vëmendje kreun e III-të, faqe 11 deri në faqen 83, të qëndrimit të Presidentit, dorëzuar që në datën 1 korrik 2021.

Në përfundim, nëse kjo pyetje e relatorit është ngritur bazuar mbi pretendimet e Kuvendit, sa më sipër keni përgjigjen shteruese.

Por nëse si Gjykatë Kushtetuese, keni ndonjë pretendim zyrtar nga ndonjë vend partner, apo përfaqësi e huaj në vendin tonë lidhur me sjellje jo korrekte të Presidentit të Republikës, lutemi të na e bëni me dije dhe do ju vëmë në dispozicion materiale plotësuese për të sqaruar Gjykatën Kushtetuese.

PËRGJIGJE PYETJEVE TË GJYQTARES, ZNJ. FIONA PAPAJORGJI

1. Nisur nga pretendimet mbi procedurat e ndjekura nga Kuvendi, nga gjithë dokumentacioni rezulton se komunikimi i parë mbi këtë çështje daton në 4.5.2021, dhe data fundore është 24.5.2021. **Lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, gjithë ky afat nuk ka qenë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen?**

Përgjigje: Procedurat dhe Rregullorja e funksionimit të Kuvendit të Shqipërisë janë tepër të qarta dhe nuk lënë asnjë hapësirë për interpretim.

Refuzimi i dëgjimit të Presidentit të Republikës në Komisionin për çështjet ligjore, është një moment procedural përcaktues dhe i pakapërcyeshëm për vijimin më tej me ngritjen e Komisionit Hetimor, dhe momente të tjera që pasojnë.

Ndaj në këtë kontekst ligjor, është e qartë se data 24 maj 2021 nuk merr më asnjë kuptim ligjor, pas shkeljes procedurale shumë të rëndë të konsumuar nga Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore.

2. Në ligj ka një afat 4 mujor fundor për veprimtarinë e Komisioneve Hetimore. Një koment për pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 9981/2002: **Nëse sipas jush, qëllimi është as të mos ngrihen, as të mos funksionojnë komisionet hetimore gjatë kësaj periudhe, a mos duhej një formulim tjetër** (duke iu referuar dispozitës)?

Përgjigje: Kjo pyetje mund t'i drejtohet Kuvendit, ndërsa shpjegimet shteruese për çështjen e afatit fundor 4 mujor gjenden në qëndrimin e Presidentit të Republikës, të dorëzuar që prej datës 1 korrik 2021.

3. Në Kushtetutë, përveç nenit 65, pika 4, a ka kufizim tjetër për periudhën fundore të veprimtarisë së Kuvendit (referuar periudhës fundore të përfundimit të legjislaturës)?

Përgjigje: Neni 77, i Kushtetutës, shprehet shumë qartë se detyrimet e Kuvendit mbi komisionet hetimore rregullohen sipas ligjit nr. 8891/2002.

Ky ligj ka parashikuar në mënyrë të qartë në nenin 4, pika 6, detyrimet për Kuvendin e Shqipërisë, sipas të cilit “Komisionet hetimore nuk mund të ngrihen gjatë 4 muajve para mbarimit të mandatit të Kuvendit.”.

Shpjegime më të detajuara janë dhënë në qëndrimin e Presidentit të Republikës depozituar që në datën 1 korrik 2021.

4. **Lidhur me nenin 77, pika 2, të Kushtetutës: Komisioni Hetimor ndryshon nga komisioni sipas nenit 90, të Kushtetutës? Mendoni se ka të njëjtat kompetenca komisioni sipas nenit 77, pika 2, dhe atij sipas nenit 90, pika 2, të Kushtetutës?**

Përgjigje: Vetë Kuvendi, që ka ndërmarrë nismën për shkarkim, ka referuar qartë nenet mbi të cilat ka mbështetur iniciativën e që lidhen me pyetjen tuaj. Saktësisht janë nenet 77, 78, të Kushtetutës, dispozitat e ligjit nr. 8891/2002 dhe Rregullores së Kuvendit. Pra, edhe vetë Kuvendi nuk ka referuar në asnjë rast nenin 90, të Kushtetutës.

Për më shumë mund të shihni vetë vendimin e Kuvendit.

5. **Ju pretendoni në qëndrimin tuaj se është krijuar një mosmarrëveshje e re kushtetuese. Mendoni se mënyra e ngritjes së kësaj mosmarrëveshjeje është e duhura?**

Përgjigje: Sqarime për këtë pyetje janë dhënë në pyetjet nr. 12 dhe nr. 13, të ngritura nga ana e relatorit, z. Kalo.

Presidenti nuk mund të përgjigjej apo reagojë ndryshe jashtë natyrës së kësaj çështjeje të iniciuar nga Kuvendi e të formalizuar vetëm me vendimin nr. 55/2021, që konsiderohet kërkesa e Kuvendit për Gjykatën Kushtetuese.

Konstatimi dhe evidentimi i kësaj mosmarrëveshjeje u krye në periudhën fundore të veprimtarisë së Komisionit Hetimor dhe që u formalizua me raportin e këtij komisioni në datën 9.6.2021.

6. **Neni 90, pika 2, referon në togfjalëshin “shkelje e rëndë e Kushtetutës”. E lëmë mënjanë në këtë rast, “krimin e rëndë”. Ju, pretendoni se në veprimet e Presidentit, **nuk ka asnjë shkelje**, apo nuk ka asnjë “shkelje të rëndë” të Kushtetutës?**

Përgjigje: Presidenti i Republikës, në asnjë veprim të tij, nuk ka konsumuar asnjë shkelje të asnjë dispozite të Kushtetutës apo të ndonjë ligji të caktuar.

Të gjitha faktet e pretenduara nga Kuvendi janë thjesht dhe vetëm intervista dhe opinione të Presidentit të Republikës, që nuk kanë as lidhjen më të largët me asnjë lloj shkeljeje. E kundërta është e vërtetë.

Presidenti në çdo rast, ka kërkuar zbatimin e Kushtetutës dhe ligjit, dhe u ka bërë thirrje të gjithë aktorëve institucionalë dhe politikë t`i respektojnë ato pa asnjë devijim.

Këto mesazhe të qarta janë publike dhe të njohura nga të gjithë shqiptarët.

MBI PYETJET E GJYQTARES, ZNJ. ELSA TOSKA

1. Sipas dokumentacionit dhe çfarë parashtruat në seancë, keni zgjedhur si strategji mbrojtjeje anën procedurale. Në kërkimin tuaj, u shprehët se kërkoni shfuqizimin e 4 vendimeve të Kuvendit. Gjatë mbrojtjes, nuk cekni anën përmbajtësore të shkaqeve të vendimit 54/2021, apo 55/2021. **Pse ky lloj qëndrimi?**

Përgjigje: Ka patur një qëndrim shumë të qartë dhe shterues qoftë sa i takon shkeljeve flagrante dhe evidente procedurale, ashtu edhe mungesës së plotë të materies përmbajtësore nga ana e Kuvendit të Shqipërisë që ka ndërmarrë nismën e shkarkimit.

Të gjitha pretendimet e Kuvendit janë të denja për t`u bazuar vetëm në një nen që nuk ekziston më në Kushtetutën e Shqipërisë, atë të “agjitacion e propagandë”.

Qëndrimi i Presidentit të Republikës, dorëzuar që në datën 1 korrik 2021, parashtrës atë të dorëzuar në datën 3 shkurt 2022, janë të plota dhe shteruese si sa i referohen anës procedurale, ashtu edhe asaj përmbajtësore.

2. Presidenti gjatë periudhës zgjedhore ka krijuar një platformë “*denonco krimin zgjedhor*”. Mund të na thoni nëse ka praktika të mëparshme, të ngjashme nga presidentët e mëparshëm? A mendoni ju që ky portal krijon mbivendosje të kompetencave të institucioneve të tjera?

Përgjigje: Në kushtet e një situatë tepër të rëndë lidhur me presionin ndaj votës së lirë dhe një morie krimesh zgjedhore që po evidentoheshin në rrugë të ndryshme, Presidenti me këtë platformë i është bashkuar të tëra përpjekjeve të aktorëve të ndryshëm të interesuar për të denoncuar krimin zgjedhor. Dhe ka zgjedhur këtë mundësi komunikimi, e cila lehtësonte denoncimin për shkak të transparencës dhe besimit të Institucioni i Presidentit të Republikës. Kjo nismë vetëm fuqizon mundësitë e denoncimit të krimit të zgjedhor, përmes një dritareje të re komunikimi me opinionin publik.

Në faqen 72, të parashtrësve të dorëzuar në datën 3 shkurt 2022, ashtu dhe në materialin e depozituar që në datën 1 korrik 2021, faqe 67 e në vijim, është theksuar se vetë prezantimi i portalit ka të sqaruar qartë qëllimin e ndërmarrjes së kësaj nisme dhe funksionimin e saj.

Në fund, çdo qytetar është i lirë të hapë një faqe në rrjetet sociale apo në çdo formë të publikimit *online*, për më tepër kur bëhet fjalë për votën e lirë. E jo më Presidenti i Republikës që është garant i Kushtetutës dhe kur bëhet fjalë për votën e lirë.

Të mos harrojmë se krimet zgjedhore të Dibrës, apo të Shijakut në vitet e fundit, tronditën edhe institucionet dhe mediat evropiane e botërore, lidhur me bashkëpunimin e shtetit me bandat për

dhunimin e zgjedhjeve. Mos hetimi i tyre në kohë dhe mosndëshkimi i autorëve realë të evidentuar qartë në përgjime, mbajti peng për vite të tëra çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

A ka patur ndonjë President të mëparshëm, në këtë situatë të kapjes së shtetit, që ka ushtruar mandatin e tij në këtë situatë ekstreme të kapjes së shtetit, pa Gjykatë Kushtetuese për 33 muaj, pa Gjykatë të Lartë për vite, me një Kuvend me 122 nga 140 deputetë që kërkon Kushtetuta, në kushtet kur opozita braktisi mandatet në bllok, e me pushtet vendor tërësisht një partiak?!

Çdo përpjekje për të gjykuar aktet dhe veprimet e Presidentit të Republikës jashtë këtyre fakteve të njohura botërisht dhe nga të gjithë qytetarët e Republikës, është sipërfaqësor, i pjesshëm, i njëanshëm, dhe në kontradiktë të fortë me realitetin e rrethanave në të cilat kanë vepruar institucionet.

3. Presidenti është subjekt i pakushtëzuar që mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Për një nga vendimet që Gjykata Kushtetuese ka dhënë vjet, Presidenti reagoi me shkresë ndaj gjyqtarëve. Si e kupton Presidenti rolin e tij si subjekt i pakushtëzuar? Si e kupton ai rolin e gjyqtarit kushtetues, kur votojnë “pro”, “kundër”, pranojnë apo rrëzojnë një kërkesë?

Përgjigje: Përgjigja e kësaj pyetjeje është shteruar gjerësisht në përgjigjen dhënë gjyqtarit relator për pyetjen nr. 26.

4. Pse zgjodhi Presidenti të shkojë fizikisht në selinë e një partie politike?

Përgjigje: Është tërësisht në diskrecionin e Presidentit të Republikës të zgjedhë formën se si zhvillon takime, vizita, ndërmer veprime, apo si ndërvepron me qytetarët, aktorët politikë, apo ata institucionale.

Në çdo rast, Presidenti i Republikës, në respekt të ligjit, ka komunikuar për ngjarje apo situata të caktuara me shkrim, apo me praninë e tij të drejtpërdrejtë. Në respekt të plotë të kësaj mënyre veprimi, ligjore dhe institucionale, ka komunikuar edhe në rastin e kësaj ngjarjeje të shëmtuar, të provokuar në mënyrë të paligjshme nga Bashkia e Tiranës, ndaj një subjekti politik, në shenjë hakmarrjeje vetëm për faktin se ishte regjistruar në koalicionin opozitar.

Sulmi politik ndaj një partie politike nga policia, sidomos gjatë periudhës zgjedhore cenon interesin publik.

Për më shumë, aktet që vërtetojnë veprimet e dhunshme e të paligjshme të Bashkisë Tiranë, i janë bashkëlidhur parashtrësive të depozituara.

5. Në vlerësimin tuaj, me çfarë lloj metodologjie matet ulja, apo rritja e rolit të Presidentit, si përfaqësues i unitetit të popullit? Cilat parametra do na çonin në vlerësimin se autoriteti i Presidentit është ulur, siç e pretendoi Kuvendi në qëndrimin e tij si pasojë? Ju mbi çfarë parametrash do e vlerësonit Institucionin e Presidentit, për të shprehur që Presidentit nuk i është ulur autoriteti, por i është rritur?

Përgjigje: Ka vetëm një parametër që vlerëson veprimtarinë e Presidentit të Republikës- ai është respekti i plotë i palëkundur dhe i pakushtëzuar i Kushtetutës dhe vlerave e parimeve të mbrojtura prej saj, që nga Preambula e Kushtetutës.

Presidenti i Republikës, me veprimet formale dhe qëndrimet publike, ka provuar botërisht se ka përmbushur plotësisht dhe në nivelin më të lartë këtë detyrë dhe mision të tij.

Megjithatë, ju sigurojmë se, në kontaktet e përditshme të Presidentit të Republikës me qytetarët dhe popullin, ai frymëzohet nga vlerësimi që ata kanë për kurajën dhe vendosshmërinë e tij si President për të mbrojtur të drejtat e tyre çdo ditë.

MBI PYETJET E GJYQTARIT ZNJ. MARSIDA XHA FERLLARI

1. Do të ndalem tek e njëjta pyetje që i bëra dhe Kuvendit. **Sipas jush, cila është rëndësia që ka procedura në këtë lloj procesi?** Po e përmbledh atë që tha Kuvendi, se jo çdo shkelje procedurale sipas tyre, ndikon në vlefshmërinë e rezultatit në fund. Qëndrimin tuaj lidhur me këtë, në raport edhe me elementin e urgjencës në proces. Ju thoni se afatet Kuvendi ia la me orë Presidentit të Republikës. **A përbën përfundimi i një afati ligjor, shkak që justifikon veprimin me urgjencë?**

Përgjigje: Procedura është thelbësore në çdo proces. Mosrespektimi i procedurave cenon vetë përmbajtjen e procesit dhe bën nul gjithë produktin e tij.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, në themel të pretendimeve e shqyrtimeve për shkelje të të drejtave themelore të njeriut, trajton me përparësi mjetet efektive, të drejtën për t'u dëgjuar, respektimin e procedurës, si elementë thelbësorë të një procesi të rregullt ligjor.

Respektimi i procedurave në çdo proces, ligjor, pro edhe kimik e laboratorik, është në funksion të përmbajtjes së vetë procesit. Ndryshe, ligjvënësi nuk do të parashikonte as Kod të Procedurave Administrative, as Kod të Procedurës Civile, as Kod të Procedurës Penale, dhe as procedura të përcaktuara në ligje të posaçme apo në akte që rregullojnë veprimtarinë e organeve më të larta, siç është Kuvendi, që ka shkelur vetë procedurën.

Kuvendi njëpartiak ka patur vetëm një objektiv politik: shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Kuvendi njëpartiak ka qënë plotësisht i vetëdijshëm për pamundësinë absolute për të realizuar një procedurë hetimore të rregullt, siç Kushtetuta, ligji dhe Rregullorja e Kuvendit e kërkon.

Për këto arsye, gjithë procedura e ndjekur është e pavlefshme, e për fat të keq, do të mbetet në rekordet e Kuvendit të Shqipërisë si një nga proceset me shkeljet më të rënda të vetëdijshme procedurale që kanë ndodhur ndonjëherë.

Si i tillë, një proces qartësisht politik, i paravendosur dhe i paragjykuar, nuk prodhon dot gjë tjetër veçse rezultate pa asnjë vlerë, qoftë nga pikëpamja juridike, qoftë në pikëpamje të vlerësimit që opinionin publik do t'i bëjë atij.

2. Në prapësimet tuaja jeni ndalur te procedura dhe nuk jeni ndalur mbi vërtetësinë e fakteve. Nuk shoh të kundërshtoni vërtetësinë e fakteve. **Pra, më konfirmoni nëse e kam kuptuar drejt: ju pretendoni se faktet janë të paplota?**

Përgjigje: Është e qartë për të gjithë se s`kemi të bëjmë aspak me fakte, por kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me metafora letrare dhe hamendësime për ngjarje që nuk ekzistojnë.

Çështjet e filozofisë së shprehjes nuk janë objekt i punës së Gjykatës Kushtetuese, por mund të jenë argumente interesante për rrethe letrare dhe diskutime mes profesionistëve të letërsisë dhe gjuhësisë.

Kemi qenë shumë të qartë dhe shterues në parashtrimin e bërë para kësaj Gjykate lidhur me të ashtuquajturat fakte të pretenduara nga Kuvendi.

Këto të ashtuquajtura fakte, ose interpretime metaforike të Kuvendit, janë të manipuluar keq, me fjali dhe fraza të shkëputura në mënyrë abuzive jashtë kontekstit, të cilat ndërtohen mbi hamendësime, pandehma, dhe supozime për ngjarje që nuk kanë ndodhur.

Kushtorja, nga kushtrimi, ndryshojnë si nata me ditën!

3. Një nga shkeljet e referuara në Raport, ka të bëjë me institucionet e pavarura (kur i drejtohej SPAK-ut, etj.). Sipas Raportit, në këto komunikime përdorshin fjali standard, të llojit “veprim me përparësi”. Kjo është interpretuar nga Kuvendi si nxitje. Është përdorur edhe një letër drejtuar Gjykatës Kushtetuese. **A keni patur ju kundërpërgjigje nga këto organe të pavarura, qoftë me shkrim, apo ndonjë ankesë ose kallëzim për ndërhyrje në institucionet e pavarura?**

Përgjigje: Presidenti i Republikës, ka komunikuar në vijimësi me institucionet e pavarura, për çështje dhe problematika që lidhen me respektimin e Kushtetutës dhe Ligjit, ku Presidenti i ka informuar, ka ngritur probleme, që lidhen me fushën e veprimtarisë së tyre, duke nxitur veprimin e tyre sa më të shpejtë, për t`i dhënë zgjidhje e për ta parandaluar situata apo ardhjen e pasojave të rënda.

Referuar pyetjes, asnjë nga këto institucione apo organe të pavarura nuk kanë patur kurrë asnjë ankesë apo vërejtje, lidhur me komunikimet e Presidentit të Republikës.

4. Çfarë specifike ka parimi i vazhdimësisë institucionale nga njëra legjislatore tek tjetra? Kjo referuar dispozitave të nenit 65, pika 4, të Kushtetutës, nenit 87, pika 1, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 4, të ligjit nr. 8891/2002? Gjithashtu, qëndrimin tuaj edhe në raport me faktin se, veprimtaria e Kuvendit rregullohet me Rregullore të vet Kuvendit, ndryshe nga institucionet e tjera kushtetuese, që veprimtarinë e kanë të rregulluar me ligj.

Përgjigje: Legjislatura e X-të aktuale e Kuvendit, nuk mund të përfaqësojë vullnetin për kërkimin që i ka bërë Gjykatës Kushtetuese Legjislatura e kaluar (e IX-të), të cilës i ka përfunduar mandati në 9 shtator 2021.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka thjesht dhe vetëm funksione të administrimit të veprimtarisë administrative të Kuvendit të Shqipërisë, e që përfaqëson Legjislaturën e X-të në marrëdhënie me të tretë, nuk ka asnjë tagër që të zëvendësojë, të përfaqësojë, apo të konfirmojë vullnetin e trupës së deputetëve që mori vendimin nr. 55/2021, në Legjislaturën IX-të. Kjo trupë është tërësisht e ndryshme nga përbërja aktuale e Legjislaturës së X-të, kur vetëm 40 deputetë aktualë kanë qenë deputetë në legjislaturën e kaluar kur u votua për shkarkimin e Presidentit.

Kryetarja e Kuvendit nuk ka asnjë tagër të zëvendësojë apo të marrë vendimet që Kuvendi i Shqipërisë i merr vetëm në seancë plenare me votimin e drejtpërdrejtë të deputetëve të saj!

Referuar parimit të vazhdimësisë midis dy legjislaturave, vetë Kuvendi i Shqipërisë, sipas nenit 87/1, të Rregullores së Kuvendit, me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve të Kuvendit, projektaktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të Kuvendit, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare, ia kthen nismëtarit. Edhe kur nismëtari është sërish deputet, duhet ta ri paraqesë nismën, dhe Seanca Plenare duhet të votojë për përfshirjen e saj në programin e punimeve të Kuvendit.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një vendim që nuk ka natyrë rregullatore/normuese, që të pretendohet se respektohet parimi i vazhdimësisë, por vendimi nr. 55/2021, i Kuvendit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, është kërkesa që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e cila duhet ta kishte shqyrtuar tërësisht këtë çështje brenda 3 muajve dhe maksimalisht deri në datën 9 shtator 2021.

Vetëm në këtë mënyrë, Gjykata do të mund të merrte vullnetin e Legjislaturës së IX-të, nëse i qëndronte ose jo kërkimeve të paraqitura, pavarësisht se këtë kërkim e ka formalizuar përmes një akti të quajtur vendim. Arsyet e tjera janë të parashtruara në qëndrimin depozituar Gjykatës Kushtetuese që prej datës 1 korrik 2021, kërkesave të Presidentit të Republikës të depozituara në muajin tetor-nëntor 2021, si dhe kërkesës paraprake të depozituar në seancën e datës 1 shkurt 2022.

5. Sa i takon nenit 90, të Kushtetutës: lidhëza “**dhe**”, i lidh domosdoshmërisht me njëra-tjetrën “shkeljen e rëndë” dhe “krimin”, apo qëndrojnë edhe autonome⁸? Duke e shpjeguar edhe në raport me tekstin e dispozitës që përcakton se Gjykata Kushtetuese **vërteton fajësinë e Presidentit**.

⁸ 1. Presidenti i Republikës nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij.

2. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet **për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë**.

Përgjigje: Është jashtë interesit interpretativ tonit dispozita e nenit 90, pasi Presidenti i Republikës nuk ka asnjë lidhje me parashikimin e kësaj dispozite.

Vetë Gjykata Kushtetuese është shprehur se interpretimi fillestar i një norme bëhet nga organi që e zbaton atë. Ndërsa interpretimi përfundimtar bëhet vetëm nga Gjykata Kushtetuese.

Nuk ka asnjë fakt që të lidhë interesin interpretativ tonin me dispozitën e nenit 90, të Kushtetutës, pasi Presidenti dhe veprimtaria e tij nuk ka asnjë lidhje me parashikimet e këtij neni.

6. Një nga shkeljet e pretenduara është ajo e shkeljes së formulës së betimit. **A keni prapësim për këtë pretendim, mbi shkeljen e formulës së betimit?**

Përgjigje: Nuk ekziston asnjë shkelje e formulës së betimit.

Pretendimet e Kuvendit janë thjesht lajthitje politike në funksion të objektivit të paravendosur, të paracaktuar dhe të paragjykuar të Kuvendit lidhur me këtë çështje.

7. Si mendoni, cili është qëllimi i ndalimit kushtetues që Presidenti nuk mund të jetë anëtar i një partie politike?

Përgjigje: Përcaktimet e nenit 89, të Kushtetutës nuk kanë asnjë lidhje me Presidentin e Republikës, sepse ai nuk ka konflikt me asnjë nga parashikimet e këtij ndalimi të formuluar në këtë dispozitë.

8. Do doja vlerësimin tuaj mbi rëndësinë që ka legjitimiteti i Kuvendit në këtë proces. **Procesi është i paligjshëm, në çdo rast që mungon legjitimiteti?**

Përgjigje: Nuk ka vend për asnjë diskutim se, një institucion pa legjitimitet, nuk mund të prodhojë kurrë një produkt të ligjshëm.

MBI PYETJET E GJYQTARIT Z. ALTIN BINAJ

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës për t`u dëgjuar në Komisionin e Ligjeve apo Kuvend: çfarë natyre ka kjo shkelje për gjithë procedurën? Është shkelje thelbësore apo e lehtë?

Përgjigje: E drejta për t`u dëgjuar është një parim themelor dhe një e drejtë kushtetuese, e cila edhe në rastin e procedurave që ndërmerr Kuvendi, është e përcaktuar qartë në Rregulloren e Kuvendit (neni 112, pika 2 e saj).

Është jashtë çdo diskutimi që shkelja e kësaj të drejte themelore përbën një shkelje tepër të rëndë dhe të pakapërcyeshme.

2. Lidhur me pretendimin për mohimin e së drejtës për t`u dëgjuar në fazën fillestare: për fazat e tjera, ka qenë kohë e mjaftueshme për Presidentin për ta ushtruar këtë të drejtë, dhe pse nuk u shfrytëzua?

Përgjigje: Pa dëgjimin e Presidentit të Republikës në Komisionin për çështjet ligjore, nuk mund të kalohej në ngritjen e komisionit hetimor. Kjo shkelje shumë e rëndë që është kryer nuk mund të “kurohet”, pasi njëra fazë kushtëzon kalimin në fazën tjetër.

3. Për shkaqe objektive, apo subjektive, Presidenti duhej të ishte personalisht, apo mund të përfaqësohej me përfaqësues në këto faza?

Përgjigje: Komisioni për çështjet ligjore ishte i detyruar të dëgjonte Presidentin e Republikës, i cili ka konfirmuar me shkresë zyrtare vullnetin e tij për t`u dëgjuar nga ky Komision.

Si e drejta për t`u dëgjuar, ashtu dhe koha e nevojshme për t`u përgatitur, janë elementë thelbësorë të garantuar me ligj, që realizojnë të drejtën e Presidentit të Republikës për t`u dëgjuar.

4. Referuar përkufizimeve të termave që jep ligji për komisionet hetimore, dhe përkufizimeve apo termave që përdor Rregullorja e Kuvendit, pse nga ana juaj vendoset shenja e barazimit mes momentit të ngritjes dhe vazhdimit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor? (kjo duke mbajtur në konsideratë se Rregullorja, përdor vetëm termat mbi ngritjen dhe përfundimin e veprimtarisë së komisionit).

Përgjigje: Kemi kërkuar gjatë gjithë kohës vetëm respektimin e parashikimeve të ligjit mbi komisionet hetimore (nr. 8891/2002) dhe Rregullores së Kuvendit, të cilat janë provuar në mënyrë të padiskutueshme se janë shkelur sistematikisht në funksion të objektivit të paravendosur politik të nismës për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Në parashtrirat tona e kemi shteruar të gjithë argumentimin mbi përcaktimet e sakta që ka Rregullorja dhe ligji për komisionet hetimore, të lidhura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

5. Pyetja tjetër lidhet me pyetjen e parë që ka bërë relatori, nëse ju pohoni vërtetësinë e provave të sjella nga Kuvendi (mbi deklaratat, thëniet, intervistat etj.). Nëse ju do i përgjigjeni me “po” kësaj pyetje, atëherë do ngrija këto pyetje të tjera:
- Lidhur me parashtrimet e Kuvendit (faqet 14 deri 17 dhe 28 deri 30 të Vendimit të Kuvendit), përdorimi i termave si “sfurqe”, “prerje dore” etj., pse ishte nevoja e evokimit të veprimeve të tilla, kur legjislacioni penal ka dënimet përkatëse penale për veprat penale kundër sistemit zgjedhor, ashtu siç ka sanksione dhe në Kodin Zgjedhor?
 - Evokimi i ndëshkimeve të tilla që përfshin gjykimin, a shkon në një linjë me detyrimin që kemi si shtet në kuadër të Konventës kundër Torturës?

Përgjigje: Meqenëse pyetja lidhet me të njëjtën pyetje të Relatorit (nr. 1 dhe nr. 31), ju ri sjellim shpjegimet përkatëse.

Provat e marra, përmes një procesi të parregullt ligjor, në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin dhe rregullat e përcaktuara për këtë qëllim, ashtu siç dhe kemi parashtruar, janë të papërdorshme dhe të pavlefshme. Të gjitha provat që Kuvendi pretendon se ia ka depozituar Gjykatës Kushtetuese, janë marrë përmes një procesi antikushtetues, në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e ligjit nr. 8891/2002, dhe Rregulloren e Kuvendit. Rrjedhimisht, dhe produkti i prodhuar duke u bazuar mbi to, është i pavlefshëm dhe i papërdorshëm.

Siç është kërkuar në parashtrimet tona, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë të shfuqizojë të gjitha vendimet e Kuvendit të Shqipërisë.

Megjithatë, kjo pyetje është ndërtuar e influencuar nga propaganda toksike publike e partisë në pushtet, e cila që prej prillit 2021 vijon pandërprerë sulmin ndaj Kreut të Shtetit.

Metaforat, epitetet, alegoritë, dhe figurat e tjera letrare, do të ishin objekt interesant debati për gjuhëtarët dhe filologët, por jo për Gjykatën Kushtetuese.

Por në funksion të respektit dhe transparencës me qytetarët shqiptarë, ju kujtojmë se fushata e 25 prillit 2021, u tensionua në nivele ekstreme për shkak të aktorëve politikë, duke kulmuar edhe me humbje jete (si ngjarja e Elbasanit), sulme të armatosura (si rasti i Kavajës), e dhjetra

ngjarje të tjera deri në situatat shumë të rënda provokative (si ngjarjet e Fierit). Të gjitha këto ngjarje kanë qenë të nxitura nga përfaqësues të partisë në pushtet dhe pasojë e mosveprimit të institucioneve ligjzbatuese.

Në një situatë kaq të rëndë, e cila po përshkallëzohej dita ditës, ishte vetëm Presidenti i Republikës, i cili mbajti qëndrime të vazhdueshme e të njëpasnjëshme, për të dekurajuar këtë përshkallëzim dhe këtë strategji tensioni, si dhe për të vënë në lëvizje institucionet që të vepronin sa më parë me qëllim kryesor parandalimin e pasojave dhe/apo ngjarjeve të/nga tjera të rënda.

Edhe në provokimin e shëmtuar të Fierit, Presidenti kërkoi publikisht kandidatëve të një force politike (LSI) të mos binin prë e provokimeve të partisë në pushtet, dhe ta tejkalonin atë situatë me urtësi. Deklaratat dhe denoncimet publike dhe shkresore të Presidentit të Republikës, kanë qenë plotësisht në proporcion të drejtë me situatën shumë të rëndë parazgjedhore dhe në funksion të parandalimit të përshkallëzimit dhe daljes jashtë kontrollit të saj.

Kushdo që do të donte ta shikonte Presidentin pasiv përpara një situatë ku proceset zgjedhore përgjaken nga humbja e jetës së njerëzve do të thotë që i bën shërbim pushtetit të dhunës dhe jo të lirive të qytetarëve.

Kushdo që do ta shikonte Presidentin e Republikës pasiv përpara shpërdorimit të parave publike nga ana e qeverisë për blerjen e votës dhe shantazhimin e qytetarëve e nëpunësve të administratës për votën e tyre, do të thotë që është pro instalimit të diktaturës një partiake dhe varrosjes *de facto* të pluralizmit në Shqipëri.

Kushdo që do ta donte ta shikonte Presidentin e Republikës, pasiv përpara kësaj situatë, dëshiron që të të legjitimohej cenimi dhe asgjësimi i të drejtës kushtetuese të të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, bazë për ndërtimin e një shtetit demokratik, ku themeli i të cili është që vota e lirë, e barabartë, e pandikuar.

Aq më tepër kur vendi futet në udhëkryq të rrezikshme për të tashmen dhe të ardhmen e tij.

Shembujt nuk mungojnë. Është i njohur reagimi i Presidentit Rumun zoti Klaus Iohannis⁹, të një vendi anëtar të NATO-s dhe vendi anëtar të BE-së.

Presidenti Iohannis iu bashkua protestës së qindra mijëra qytetarëve rumunë, që protestonin për një ligj që lidhej me konfliktin e interesit, dhe ai e deklaroi publikisht përpara protestuesve që veprimi i qeverisë, ishte fillimi i një grushti shteti.

Ky presion publik, detyroi qeverinë rumune të kohës, të tërhiqte ligjin, dhe askush nuk guxoi ta akuzonte Presidentin rumun Iohannis, por përkundrazi populli rumun dhe opinioni i gjerë

⁹ <https://www.cotidianul.ro/ce-vazut-iohannis-dupa-ce-urmarit-cu-foarte-mare-atentie-protestele/>

ndërkombëtar, mbështetën këtë veprim në mbrojtje të shtetit ligjor, Kushtetutës, dhe luftës kundra korrupsionit.

Ky rast demonstroi se kur interesi publik vihet në rrezik, çdo reagim i fortë i Presidentit është një garanci, një mundësi dhe një shpresë, për mbrojtjen e unitetit të shtetit dhe garantimin e interesave të qytetarëve të vendit.

Ndërkohë që, në Shqipëri, Presidenti i Republikës, është përballur me një situatë shumë herë më të rëndë se kaq, sepse atakohej drejtpërsëdrejti Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese, shteti i së drejtës, interesi publik, sistemi i drejtësisë në tërësi, dhe ndarja, pavarësia dhe balanca ndërmjet pushteteve.

6. Kuvendi pretendon se në dalje publike ka patur fyerje ndaj personave me funksione publike. A pranohet ky fakt?

Përgjigje: Presidenti i Republikës është atakuar në të gjitha llojet e formave, dhe kjo fushatë fyerjesh dhe denigrimi është frymëzuar personalisht nga Kryetari i Partisë Socialiste dhe Kryeministri i vendit Edi Rama.

Faktet shumë të rënda publike lidhur me këtë gjenden në qëndrimin e dorëzuar që prej datës 1 korrik 2021, duke filluar që nga vendosja e Posterave të mëdhenj publik vendosur në akset kombëtare të vendit, nga Kryeqyteti, deri në qytete të tjera, ashtu si dhe në aktivitetet politike elektorale të Kryeministrit, i cili me video, foto, fjalë, ka fyer haptazi dhe publikisht Presidentin e Republikës.

Këto fakte janë të njohura prej të gjithë shqiptarëve. Për këtë pyetje, kemi dhënë sqarime shteruese, edhe në përgjigje të pyetjes me nr. 2, të relatorit.

Është me rëndësi që edhe Gjykata të rishohë dhe tre video ku shfaqen thirrje fyese dhe sulmuese të kryeministrit ndaj Presidentit në disa mitingje/aktivitete. Bashkëlidhur këtij materiali gjeni videot përkatëse në format CD.

Për më tepër, lutemi t'i referoheni faqes 66, 70, dhe 97-103 të qëndrimeve të dorëzuara që prej datës 1 korrik 2021.

7. Nisur nga situatat e krizës në vend siç cituat ju, Presidenti ka bërë përpjekje për t'i adresuar problemet në institucionet përkatëse. I pranojmë se i ka këto shqetësime, në momentin që i bën të njohura publikisht ato, qoftë dhe në situatë krize, a ka detyrimin që kur i shpreh ato, të jetë i përmbajtur? Apo mund edhe të mos jetë?

Përgjigje: Presidenti i Republikës, në mënyrë institucionale dhe ligjore i ka shprehur dhe adresuar gjerësisht problematikat, dhe me vetëpërbajtjen e tij ka qenë faktori i vetëm institucional ekuilibruar në vend, në një moment kur aktorët politikë kishin tensionuar në ekstrem situatën e cila kishte përshkallëzuar deri edhe me humbje jete.

Vetëpërbajtja, është relative dhe dinamike. E rëndësishme dhe e domosdoshme është që vetëpërbajtja e Presidentit të Republikës të udhëhiqet nga interesi më madhor i vendit, i mbrojtjes së Kushtetutës si edhe nga proporcionaliteti që diktohet nga rrethanat konkrete dhe sjelljet e aktorëve të tjerë.

8. Përbajtja e letrës drejtuar Gjykatës Kushtetuese, është një ndër pretendimet e Kuvendit. Materiale të tilla publike, i shërbejnë unitetit, kohezionit të trupës gjyqësore, apo është e kundërta?

Përgjigje: Kjo përgjigje është shteruar në përgjigjen e dhënë ndaj pyetjes nr. 26 të gjyqtarit relator zoti Kalo.

Megjithatë, jua ri sjellim në vëmendje: Presidenti i Republikës ka zbatuar çdo vendim të Gjykatës Kushtetuese. Nuk ekziston asnjë rast i vetëm ku ai të ketë refuzuar zbatimin e këtyre vendimeve.

Madje Presidenti ka qenë konsekuent dhe parimor në qëndrimin e tij, për një drejtësi larg presioneve politike, gjë që, ai edhe në shkresën drejtuar Gjykatës Kushtetuese se, shprehimisht thotë:

“Lidhur me këtë ju garantoj se, si President i Republikës, do të ofroj të gjithë mbështetjen time, në dhënien e drejtësisë kushtetuese, për ta mbajtur Gjykatën Kushtetuese larg presioneve politike, edhe pse aktualisht pjesa tjetër e strukturës kryesore të shtetit (si parlamenti dhe qeveria) jo vetëm që nuk angazhohen për mirëfunksionimin dhe mbrojtjen e rendit juridik të shtetit tonë, por kanë bërë dhe po bëjnë çdo gjë, si përmes procesit legjislativ, ashtu dhe keq qeverisjes, duke vënë në rrezik permanent në shumë raste interesat kombëtare, interesin publik, sovranitetin e vendit dhe pluralizmit politik, e duke e kthyer vendin tonë, në një vend ku demokracia të njihet vetëm në letër, ndërsa në praktikë të ekzistojë një regjim autokratik një partiak.”

Asnjë institucion nuk del jashtë sistemit demokratik të llogaridhënies, përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese.

Prandaj edhe në Kushtetutë është parashikuar procedimi disiplinor edhe i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, apo të Gjykatës së Lartë për të rritur ndjenjën e përgjegjësisë, dhe për të garantuar edhe llogaridhënien e tyre përpara Kushtetutës dhe ligjit.

Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese ka karakter suprem në Republikën e Shqipërisë, por të mos harrojmë se jemi anëtarë të shumë konventave ndërkombëtare dhe evropiane, dhe i nënshtrohemi detyrimeve ndërkombëtare dhe juridiksionit të gjykatave ndërkombëtare.

Prandaj çdo vendim i sistemit tonë gjyqësor që dështon në dhënien e drejtësisë, e shkakton pasoja serioze për shtetin e qytetarët (mjafton të kujtojmë penalitetet për Shqipërinë në gjyqet e arbitrazhit), çka ngarkon me përgjegjësi autoritetet që kanë shqyrtuar çështjet jashtë standardeve evropiane.

Lidhur me këtë pyetje, mund të sjellim një përgjigje të vetë Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë, lidhur me kritika të Presidentit të atij vendi, për disa vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese rumune. Në Opinion Këshillimor nr. 1, të datës 5 prill 2007, botuar në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 258, datë 18.04.2007, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë, mes të tjerash është shprehur se¹⁰:

“Referuar fakteve të sipërcituara, që i ngarkohen Presidentit të Rumanisë, nuk mund të pretendohet se ai ka shkelur parashikimet mbi pavarësinë e gjyqësorit duke bërë kritika ndaj magistratëve, përfshirë ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. [...]”

¹⁰ Burimi i këtij citimi, përkthyer nga ana jonë: <https://legislatie.just.ro/Public/DetaliiDocument/81245>

MBI PYETJET E GJYQTARES, ZNJ. SONILA BEJTJA

1. Lidhur me rekomandimet e Komisionit Hetimor në vitin 2020, për një ligj organik për Presidentin e Republikës, Kuvendi pranoi se është në fazë draftimi. **A jeni përfshirë ju për ndonjë koment, mendim, konsultim për këtë ligj deri më tani?**

Përgjigje: Institucioni i Presidentit të Republikës nuk ka asnjë dijeni për një nismë të tillë, dhe as të ndonjë depozitimi të projektligji për diskutim apo tryezë.

Është e vërtetë që Komisioni Hetimor i ngritur në vitin 2019 për hetimin e Presidentit, e mbylli veprimtarinë e tij në korrik 2020 dhe me vendimin nr. 48/2020, datë 27.7.2020, miratoi raportin e miratuar nga Kuvendi, ku si konkluzion në pikën 142, ndër të tjera, Kuvendi i Shqipërisë miratoi edhe rekomandimin për rishikimin e dispozitave Kushtetuese, për të qartësuar kompetencat formale dhe substanciale të Presidentit, dhe parashikimin e tyre shprehimisht në ligjin organik për Institucionin e Presidentit të Republikës.

Ky Komision Hetimor, siç dihet, e mbylli veprimtarinë e tij u mbyll pa rezultat, për shkak se nuk rezultuan shkelje të Kushtetutës nga Presidenti që të legjitimonin shkarkimin, ndërkohë që Komisioni i Posaçëm Hetimor parlamentar pushoi së ekzistuari. Për më tepër referojuni faqen 38-41 të parashtrimeve të dorëzuar me shkrim. në Gjykatën Kushtetuese.

2. Ju ngrini pretendime për afatin 4 mujor dhe për nevojën e ri konfirmimit të vullnetit të Legjislaturës së IX-të, nga Legjislatura e X-të. Mendoni se ri konfirmimi i këtij vullneti mund të ndreqë shkeljet ligjore të atij komisioni hetimor? Mbi cilin ligj do të duhej të bëhej ky ri konfirmim i vullnetit?

Përgjigje: Sa i takon shkeljeve të rënda procedurale, të faktuara tashmë, dhe të konsumuara në vazhdimësi e në mënyrë të përsëritur, ato janë të pakapërcyeshme dhe ngarkojnë me përgjegjësi të rëndë Kuvendin e Shqipërisë.

Për pjesën tjetër të pyetjes, po ju ri sjellim në vëmendje shpjegimet e dhëna për pyetjen nr. 2, të relatorit:

Legjislatura e X-të aktuale e Kuvendit, nuk mund të përfaqësojë vullnetin për kërkimin që i ka bërë Gjykatës Kushtetuese Legjislatura e kaluar (IX-të), të cilës i ka përfunduar mandati në 9 shtator 2021.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka thjesht dhe vetëm funksione të administrimit të veprimtarisë administrative të Kuvendit të Shqipërisë, e që përfaqëson Legjislaturën e X-të në

marrëdhënie me të tretë, nuk ka asnjë tagër që të zëvendësojë, të përfaqësojë, apo të konfirmojë vullnetin e trupës së deputetëve që mori vendimin nr. 55/2021, në Legjislaturën IX-të.

Kjo trupë është tërësisht e ndryshme nga përbërja aktuale e Legjislaturës së X-të, kur vetëm 40 deputetë aktualë kanë qenë deputetë në legjislaturën e kaluar kur u votua për shkarkimin e Presidentit.

Kryetarja e Kuvendit nuk ka asnjë tagër të zëvendësojë apo të marrë vendimet që Kuvendi i Shqipërisë i merr vetëm në seancë plenare me votimin e drejtpërdrejtë të deputetëve të saj!

Referuar parimit të vazhdimësisë midis dy legjislativave, vetë Kuvendi i Shqipërisë, sipas nenit 87/1, të Rregullores së Kuvendit, me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve të Kuvendit, projekt aktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të Kuvendit, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare, ia kthen nismëtarit. Edhe kur nismëtarit është sërish deputet, duhet ta ri paraqesë nismën, dhe Seanca Plenare duhet të votojë për përfshirjen e saj në programin e punimeve të Kuvendit.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një vendim që nuk ka natyrë rregullatore/normuese, që të pretendohet se duhet të respektohet parimi i vazhdimësisë, por vendimi nr. 55/2021, i Kuvendit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, është kërkesa që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e cila duhet ta kishte shqyrtuar tërësisht këtë çështje brenda 3 muajve dhe maksimalisht deri në datën 9 shtator 2021.

Vetëm në këtë mënyrë, Gjykata do të mund të merrte vullnetin e Legjislaturës së IX-të, nëse i qëndronte ose jo kërtimeve të paraqitura, pavarësisht se këtë kërkim e ka formalizuar përmes një akti të quajtur vendim.

Arsyet e tjera janë të parashtruara në qëndrimin depozituar Gjykatës Kushtetuese që prej datës 1 korrik 2021, në kërkesat e Presidentit të Republikës të depozituara në muajin tetor-nëntor 2021, si dhe në kërkesën paraprake të depozituar në seancën e datës 1 shkurt 2022.

MBI PYETJET E GJYQTARES, ZNJ. VITORE TUSHA

1. Keni kundërshtuar gjithë procedurën e ndjekur nga Kuvendi, dhe si një nga pasojat keni evidentuar dhe ndërhyrjen e Kuvendit tek roli dhe pozita që ka Presidenti sipas Kushtetutës, si dhe krijimin e një mosmarrëveshje të re kompetence, duke e quajtur si hakmarrje apo tentativë për të minimizuar rolin e Kreut të Shtetit. **Lutem specifikoni më konkretisht pasojat që kanë ardhur në këtë drejtim.**

Përgjigje: Shkeljet e rënda, të përsëritura, dhe të njëpasnjëshme procedurale të kryera nga Kuvendi i Shqipërisë, kanë sjellë si pasojë: mohimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuese; konfliktualitetin mes dy organeve (Kuvend- President) për shkak të mosshqyrtimit për një kohë të gjatë të këtij konflikti nga Gjykata Kushtetuese. Konflikti u transferua nga legjislatura e IX-të tek ajo e X-ta (aktuale).

Një situatë e tillë, me një çështje të mbajtur pezull ndaj Presidentit të Republikës, i ka mundësuar mazhorancës në pushtet të vazhdojë sulmet e paligjshme, të pa principa, dhe amorale ndaj Presidentit të Republikës, dhe të amplifikuara nga mediat që mbështesin Qeverinë, fakte këto të provuara gjerësisht.

Etiketimi sistematik i Kreut të Shtetit me terma si “President i shkarkuar” për muaj të tërë, është në dëm të unitetit të popullit që ai përfaqëson dhe ka krijuar një debat artificial të panevojshëm, e cila edhe kjo shkon në dëm të imazhit të vendit dhe kredencialeve të tij në arenën ndërkombëtare.

Kjo situatë pezullie ka krijuar vështirësi edhe në komunikim ndërmjet institucioneve, ku institucionet në varësi të ekzekutivit, shpesh herë kanë arritur deri aty sa të zvarrisin për një kohë të gjatë dhënien e informacioneve, përcjelljen e tyre në mënyrë shumë të cunguar, apo edhe të mos përgjigjen fare, për më tepër që bëhej fjalë për çështje me interes të lartë publik.

2. Përbërjen e Legjislaturës së IX-të të Kuvendit (pra heqjen dorë nga mandatet dhe përbërja e Kuvendit pas këtij momenti), e sillni si fakt lidhur me kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve? Si lidhet ky fakt me çështjen konkrete? A sjell ndikim në proces? Apo thjesht e përmendni në kontekstin e fakteve (*duke mos harruar se ajo legjislaturë ka miratuar ndryshime në Kushtetutë dhe ka miratuar ligje gjatë veprimtarisë së saj*).

Përgjigje: Problematika e legjitimitetit të Legjislaturës së IX-të, është ezauruar në mënyrë shteruese në qëndrimin e Presidentit të Republikës të depozituar që në datën 1 korrik 2021, ashtu dhe në atë të depozituar në datën 3.2.2022.

3. Me çfarë mjeti, mënyre, procedure mund të formalizojë vullnetin e legjislaturës së IX-të, legjislatura e X-të?

Përgjigje: Në përgjigje të pyetjes suaj, ju përcjellim sqarimet tona në përgjigje të pyetjes nr. 2 të relatorit, dhe pyetjes nr. 4, të gjyqtares Marsida Xhaferllari:

Legjislatura e X-të aktuale e Kuvendit, nuk mund të përfaqësojë vullnetin për kërkimin që i ka bërë Gjykatës Kushtetuese Legjislatura e kaluar (e IX-të), të cilës i ka përfunduar mandati në 9 shtator 2021.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, e cila ka thjesht dhe vetëm funksione të administrimit të veprimtarisë administrative të Kuvendit të Shqipërisë, e që përfaqëson Legjislaturën e X-të në marrëdhënie me të tretë, nuk ka asnjë tagër që të zëvendësojë, të përfaqësojë, apo të konfirmojë vullnetin e trupës së deputetëve që mori vendimin nr. 55/2021, në Legjislaturën IX-të. Kjo trupë është tërësisht e ndryshme nga përbërja aktuale e Legjislaturës së X-të, kur vetëm 40 deputetë aktualë kanë qenë deputetë në legjislaturën e kaluar kur u votua për shkarkimin e Presidentit.

Kryetarja e Kuvendit nuk ka asnjë tagër të zëvendësojë apo të marrë vendimet që Kuvendi i Shqipërisë i merr vetëm në seancë plenare me votimin e drejtpërdrejtë të deputetëve të saj!

Referuar parimit të vazhdimësisë midis dy legjislaturave, vetë Kuvendi i Shqipërisë, sipas nenit 87/1, të Rregullores së Kuvendit, me mbarimin/mbylljen e legjislaturës së punimeve të Kuvendit, projektaktet e depozituara për shqyrtim e miratim, pjesë e programit të punimeve të Kuvendit, që për arsye të ndryshme nuk kanë arritur të miratohen në seancë plenare, ia kthen nismëtarit. Edhe kur nismëtari është sërish deputet, duhet ta ri paraqesë nismën, dhe Seanca Plenare duhet të votojë për përfshirjen e saj në programin e punimeve të Kuvendit.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një vendim që nuk ka natyrë rregullatore/normuese, që të respektohet parimi i vazhdimësisë, por vendimi nr. 55/2021, i Kuvendit, sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 8577/2000, është kërkesa që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e cila duhet ta kishte shqyrtuar tërësisht këtë çështje brenda 3 muajve dhe maksimalisht deri në datën 9 shtator 2021.

Vetëm në këtë mënyrë, Gjykata do të mund të merrte vullnetin e Legjislaturës së IX-të, nëse i qëndronte ose jo kërkimeve të paraqitura, pavarësisht se këtë kërkim e ka formalizuar përmes një akti të quajtur vendim. Arsyet e tjera janë të parashtuara në qëndrimin depozituar Gjykatës Kushtetuese që prej datës 1 korrik 2021, kërkesave të Presidentit të Republikës të depozituara në muajin tetor-nëntor 2021, si dhe kërkesës paraprake të depozituar në seancën e datës 1 shkurt 2022.

MBI PYETJET E PËRFAQËSUESVE TË KUVENDIT, ZNJ. KLOTILDA BUSHKA DHE Z. ERIND MËRKURI

1. Në pretendimet tuaja u ngrit çështja e antikushtetutshmërisë së Kuvendit. Ndërkohë që Kuvendi, gjatë legjislaturës, nisi dy procedura hetimore, ku në të parën Presidenti mori pjesë. Kurse në vitin 2021, nuk e njohu legjitimitetin e Kuvendit. **Çfarë ndryshoi në këtë që ndodhi?**

Përgjigja: Komisioni për Çështjet Ligjore në datat 5-6 maj 2021 i mohoi të drejtën për t'u dëgjuar Presidentit të Republikës, ashtu siç Rregullorja e Kuvendit në nenin 112, pika 2, përcakton.

Është fare e qartë që të gjitha hapat dhe fazat procedurale të tjera janë cenuar në mënyrë të pandreqshme dhe nga kjo paligjshmëri thelbësore. Ndërkohë që situata procedurale u rëndua edhe më tepër për shkak se Kuvendi nuk mund të ngrinte dhe aq më pak të funksiononte një Komision Hetimor në 4-muajt e fundit të mandatit të vet Kuvendit.

Ndërkohë që znj. Bushka, e di fort mirë se, Legjislatura e IX-të ka ngritur dy komisione hetimore ndaj Presidentit të Republikës. Të dyja herët, kërkesa është paraqitur nga deputetët e mazhorancës dhe të shqyrtuara nga i njëjti Komision dhe Kryetar për Çështjet Ligjore.

Por, ka një ndryshim thelbësor mes këtyre dy rasteve. Sepse, në rastin e parë, të qershorit 2019 kur u paraqit kërkesa e disa deputetëve për ngritjen e komisionit hetimor ndaj Presidentit për shtyrjen e datës së zgjedhjeve lokale, siç e referon në pyetje dhe znj. Bushka, Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore, z. Ulsi Manja, përmes shkresës nr. 2502/3 prot., datë **19.06.2019** (kopje të së cilës e dorëzojmë bashkëlidhur), e vuri në dijeni Presidentin në mënyrë të shprehur qartë se, në datën **24 qershor 2019, ora 10:00**, (pra 5-ditë nga njoftimi) do të shqyrtohej nga Komisioni i Ligjeve kërkesa e deputetëve për shkarkimin e Presidentit, duke i kërkuar Presidentit të Republikës që t'i bënte me dije Komisionit për çështjet ligjore, nëse sipas nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, kërkonte për t'u shprehur në Komision, ose jo, me qëllim garantimin e së drejtës së tij për t'u dëgjuar në Komision.

Ky fakt është cituar edhe shprehimisht në Raportin e datës 26.06.2019¹¹ (kopje bashkëlidhur), të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në paragrafët 7, 8 dhe 9, të këtij Raporti.

Pra siç rezulton, po i njëjti Komision për çështjet ligjore, me të njëjtin kryetar, në qershor të vitit 2019, e kuptonte shumë mirë rëndësinë e respektimit të procedurës dhe së drejtës për t'u dëgjuar, sipas nenit 112, pika 2, të Rregullores së Kuvendit.

¹¹ Për më tepër, referojuni përmbajtjes së Raportit në faqen zyrtare të Kuvendit, në link-un: <https://www.parlament.al/Projekte/PPPDetailes/532>

Ndërkohë që po i njëjti komision (me të njëjtën përbërje dhe Kryetar), në 4 maj të vitit 2021, i dërgon fillimisht një shkresë pa objekt të qartë dhe pa kuptim, e më pas në datë 5.5.2021, e thërret Presidentin e Republikës, duke i lënë vetëm pak orë kohë, dhe refuzon në mënyrë të përsëritur kërkesën e tij për t'u dëgjuar, brenda një kohe të arsyeshme, në datën 10 maj 2021.

2. Keni pretenduar shkelje të rëndë të procedurës në fazën e parë. Në shkresat e datës 5 dhe 6 maj 2021, gjithashtu keni ngritur disa pretendime për mungesë legjitimiteti (citim). Atëherë:
- Çfarë argumenti tjetër mund të paraqiste Presidenti, që nuk e paraqiti?
 - Çfarë e pengoi t'i paraqiste këto argumente në Komisionin Hetimor, në Seancë Plenare, dhe në Gjykatë Kushtetuese?

Përgjigje: Procedura e ndjekur përbën një nga momentet më të rënda të shkeljeve procedurale në historinë e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo situatë ngarkon me përgjegjësi Kuvendin, i cili në funksion të objektivit politik të paracaktuar, shkeli ligjin dhe dëmtoi tepër rëndë imazhin e Institucionit që është themeli i Republikës Parlamentare, duke tronditur besimin e qytetarëve tek të zgjedhurit e tyre, si dhe misionin e Kuvendit për të qenë institucioni shembull në zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve të vendit.

3. Raporti i Erind Mërkurit përmban konkluzione? A konsiderohet provë? A qëndron vendimi i Kuvendit dhe Raporti hetimor, pa këtë opinion?

Përgjigje: Meqenëse kjo pyetje u bë në seancë nga vet zoti Mërkuri në cilësinë e përfaqësuesit të Kuvendit, dhe në konflikt të hapur interesi, ky është një tjetër moment që rëndon akoma edhe më shumë të gjithë integritetin procedural të hapave që ka ndërmarrë dhe realizuar Kuvendi përmes Komisionit Hetimor të shkarkimit të Presidentit të Republikës.

Ashtu sikurse e kemi kërkuar qartësisht në seancë, ky rast i keqpërdorimit të veprimtarisë parlamentare dhe cilësive që duhet të ketë një ekspert i pavarur, meriton një qëndrim dhe reagim të veçantë të Gjykatës Kushtetuese.

4. Në raportet e OSBE/ODHIR, referohet se presidenti bëri fushatë (citim...). **Çfarë komenti keni për këtë citim?**

Përgjigje: Raportet e OSBE/ODHIR, konfirmuar katërciprisht të gjitha shqetësimet madhore dhe të përsëritura nga Presidenti i Republikës, përgjatë gjithë periudhës që i parapriu fushatës së datës 25 prill. Në Raportet e OSBE/ODHIR në mënyrë të përmbledhur faktohet se:

- Qeveria realizoi shitblerjen më kriminale dhe masive të votave të parë ndonjëherë.

- Qeveria e përdori pushtetin duke shpërdoruar në mënyrë kriminale të dhënat personale të qindra mijëra qytetarëve, të cilat janë tashmë në duart e krimit të organizuar dhe trafikanteve duke tronditur rendë sigurinë publike dhe atë personale të qytetarëve.
- Qeveria shpërdoroi pushtetin dhe administratën për presione mbi qytetarë dhe biznese, përdori dhjetra milion euro dhe e gjithë administrata u përdor kundër qytetarëve.
- Dhjetra mijëra qytetarëve shqiptarë, emigrantë në Greqi dhe Maqedoni, iu mohua e drejta e votës në mënyrë antikushtetuese nga qeveria me vendime të paligjshme.
- Qeveria kapi dhe zaptoi kriminalisht dhe totalisht median, për të mashtruar dhe dezinformuar qytetarët për qëllimet elektorale të rilindjes.
- Qeveria punësoi me mijëra njerëz në mënyrë të paligjshme në administratën publike, vetëm me qëllime elektorale.
- Qeveria shpërdoroi dhjetra milionë eurot e rindërtimit për të orientuar votën.
- Qeveria përdori grupet kriminale për të ushtruar presion ndaj zgjedhësve.

Nga përmbajtja, e gjetjeve, konstatimeve dhe rekomandimeve të OSBE/ODHIR në të tre raportet që prodhoi për monitorimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021, provohet në mënyrë të pakundërshtueshme se, shqetësimet e kahershme të Presidentit të Republikës dhe të bëra publike në mënyrë të vazhdueshme, ishin të drejta, pasi vinin si rezultat i një vlerësimi objektiv dhe koherent të sjelljes së mazhorancës qeverisëse, e cila me veprimet e saj në vijimësi po tregonte se do të bënte, siç dhe bëri gjithçka për shtrembërimin e vullnetit të zgjedhësve, me qëllim ndikimin të zgjedhësi për të krijuar avantazhe politike në favor të saj në këtë proces zgjedhor.

E vetmja “fushatë” e Presidentit të Republikës, ka qenë ajo e mbrojtjes së integritetit të procesit zgjedhor, përmes platformës transparente “Denonco krimi zgjedhor”, për të nxitur institucionet ligjzbatuese për të vepruar në kohë dhe për të dekurajuar nxitësit dhe autorët krimeve zgjedhore.

Nëse kjo, nga përfaqësuesit e Kuvendit konsiderohet si fushatë kundër partisë në pushtet, kjo duhet kuptuar në harmoni me konkluzionin e Raportit të OSBE/ODHIR-it se shteti dhe partia u shkrinë në një, duke cenuar integritetin e procesit zgjedhor.

Në përfundim të dhënies së këtyre përgjigjeve për Gjykatën Kushtetuese dhe për përfaqësuesit e Kuvendit, duhet t'i risjell në vëmendje Gjykatës një shembull objektiv, të qëndrueshëm mbi rolin e Kreut të Shtetit, në mënyrë të veçantë në kohë krize, apo të tensionimit ekstrem të situatës politiko- shoqërore.

Shembulli i Presidentit të Rumanisë, z. Ioannis, i cili në mbrojtje të interesit publik, iu bashkua protestës së qindra mijëra qytetarëve rumunë, me moton “Për pengimin e një grushti institucional”, siç e quajti ai për shkak të miratimit të një ligji që lidhej me konfliktin e interesit,

është pa asnjë diskutim konkretizimi praktik i veprimtarisë së Kreut të Shtetit në mbështetje të palëkundur të interesit më të lartë publik.

Gjithashtu, është momenti i duhur për të sjellë në vëmendje të Gjykatës Kushtetuese, sërisht nga Rumania, si një vend anëtar i NATO-s, anëtar i Bashkimit Evropian dhe pjesë e Ballkanit tonë të përbashkët, se si është shprehur Gjykata Kushtetuese rumune në vitin 2007, duke interpretuar rolin e Kreut të Shtetit për një situatë që për sa i takon gravitetit të saj, nuk ka të krahasuar me krizën në të cilën është gjendur dhe gjendet vendi ynë prej një periudhe disavjeçare.

Në Opinion Këshillimor nr. 1, të datës 5 prill 2007, botuar në Fletoren Zyrtare të Rumanisë nr. 258, datë 18.04.2007, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë, mes të tjerash është shprehur se¹²:

“Në të njëjtën kohë, sipas nenit 80 paragrafi (1) të Kushtetutës, Presidenti i Rumanisë është garantues i pavarësisë kombëtare, unitetit dhe integritetit territorial të vendit, dhe sipas paragrafit (2) të të njëjtit nen, garanton funksionimin e duhur të autoriteteve publike dhe ushtron funksionin e ndërmjetësimit ndërmjet pushteteve shtetërore, si dhe ndërmjet shtetit dhe shoqërisë.

Prerogativat kushtetuese si dhe legjitimiteti demokratik i dhënë nga zgjedhja e tij [...] kërkojnë që Presidenti i Rumanisë të luajë një rol aktiv, prania e tij në jetën politike nuk mund të reduktohet në një ushtrim simbolik dhe protokollar.

Funksionet e garancisë dhe të vigjilencës të parashikuara në nenin 80 paragrafi (1) të Kushtetutës nënkuptojnë me përkufizim vëzhgimin e kujdesshëm të ekzistencës dhe funksionimit të shtetit, mbikëqyrjen vigjilente të mënyrës së veprimit të aktorëve të jetës publike - autoriteteve publike, organizatave të legjitimuara nga Kushtetuta, shoqëria civile dhe respektimi i parimeve dhe normave të përcaktuara me Kushtetutë, mbrojtja e vlerave të parashikuara në Ligjin Themeltar. As ora, as funksioni i garancisë nuk kryhet në mënyrë pasive, me soditje, por me veprimtari të gjallë e konkrete.

Duke patur parasysh këto konsiderata, Gjykata konstaton se Presidenti i Rumanisë, në bazë të prerogativave dhe legjitimitetit të tij, mund të shprehë opinione dhe opsione politike, të bëjë vëzhgime dhe kritika në lidhje me funksionimin e autoriteteve publike dhe eksponentëve të tyre, të propozojë reforma ose masa të cilat i konsideron të dëshirueshme për interesin kombëtar.

Megjithatë, mendimet, vëzhgimet, preferencat apo kërkesat e Presidentit nuk janë vendimmarrëse dhe nuk prodhojnë efekte juridike, dhe autoritetet publike mbeten ekskluzivisht përgjegjëse për përvetësimin e tyre, apo injorimin e tyre. Në çdo rast, ushtrimi nga Presidenti i një roli aktiv në jetën politike dhe shoqërore të vendit nuk mund të cilësohet si sjellje në kundërshtim me Kushtetutën.

Referuar fakteve të sipërcituara, që i ngarkohen Presidentit të Rumanisë, nuk mund të pretendohet se ai ka shkelur parashikimet mbi pavarësinë e gjyqësorit duke bërë kritika ndaj magistratëve, përfshirë ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. [...]”

¹² Burimi i këtij citimi, përkthyer nga ana jonë: <https://legislatie.just.ro/Public/DetaliiDocument/81245>

Ky opinion i Gjykatës Kushtetuese rumune, është një shembull i qartë se çfarë përfaqëson një President, si duhet ta luajë rolin e tij, cilat janë hapësirat ku ai shtrin veprimtarinë e tij, dhe fare qartë ka një analogji të gjerë me kontekstin kushtetues shqiptar, dhe bën të qartë për këdo që veprimet dhe qëndrimet e Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta, në çdo situatë dhe në çdo moment, kanë qenë në përputhje dhe në respekt të plotë me Kushtetutën e vendit dhe me ligjet përkatëse, e në shërbim të interesit më të lartë publik.

Tiranë, më 07 shkurt 2022.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
ILIR META**

Me Autorizim nr. 203, datë 17.01.2022

**Këshilltari i Presidentit të Republikës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
BLEDAR DERVISHAJ**

**Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Institucionin e Presidentit të Republikës
KATRIN TRESKA**